

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVI i botimit, nr. 183, Janar 2019

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## VIT TË MBARË O SHKODER: POLITIKA E MIRË ËSHTË NË SHËRBIM TË PAQES 2

Këtë vit, më 09.01.2019, ora 17.30-19.30 Arqipeshkvia Shkodër-Pult dhe Komisioni "Drejtësi dhe Paqe" në bashkëpunim me Bashkinë Shkoder, Teatrin "Migjeni" zhvilluan aktivitetin e përvitshëm "Vit të mbarë o Shkoder: Politika e mirë është në shërbim të paqes" që i referohet mesazhit të Atit të Shenjtë Françesk për Ditën Botërore të Paqes.

Moderatorët e mirënjohur të StarPlus TV, Ergys Kavaja dhe Emi Kavaja e hapën aktivitetin duke iu referuar motos së Shenjtërisë së tij Papa Françesku me mesazhin që i drejton botës për çdo fillim viti. Politika e mirë është në shërbim të paqes mund të interpretohet si një këmbanë alarmi për veshët e atyre që popujt i kanë zgjedhur për tu prirë në rrugën drejt qëndrueshmërisë ekonomike të zhvillimit shoqëror dhe të bashkë-ekzistencës paqësore. Përgjegjësia e udhëheqësve politikë që bota po kalon është e padiskutueshme.



## SHKODRA, SHTRON MBYLLJEN E MADHE TË VITIT 2018

Ditët dhe netët kalojnë një nga një, muajt dhe stinët pasojnë njëri-tjetrin dhe dalë nga dalë kalendari plotëson vitin që po lëmë pas, një vit që gjithmonë; ditë për ditë, muaj për muaj dhe stinë për stinë lë pas ngjarje të bukura, por dhe të hidhura në jetën e përditshme të një populli. Fundi i këtij viti, apo mbyllja e një kalendari vjetor sfumon ngjarjet e trishtueshme dhe frymëzon njerëzit që kapërcimin nga një vit në tjetër ta bëjnë sa më të gëzueshëm. 6

## NATA TRADICIONALE - FESTIVALI BURIMOR "TREVA - 2019" 3

Tashmë është bërë traditë që ansambli folkloriko – kulturor "Treva", në çdo fund viti të organizojë natën tradicionale, me krijimet më të mira të vitit. Edhe sivjet, me 24 dhjetor, u organizue veprimtarine e 16-të në prag të Krishtlindjes e Vitit të Ri, në tempullin e artit e kulturës, në teatrin "Migjeni", nga shoqata kulturore – artistike "Treva", me drejtuesit e saj kryesor, tashmë të afirmuar e të dashur për folkdashësit, zotërinjtë Fran Kodra dhe Ndue Shytani, në bashkëpunim edhe me bashkinë Shkodër

## URIMI IM PËR VITIN 2019!

Të nderuar miq të fjalës si vlere universale! Këtu, nga Italia fqinje, ku po kaloj pushimet dimërore pranë fëmijëve, krahas kënaqësisë që më sjelle mjedisi kaq brilant i një qyteti kaq të preferuar, sidomos nga shqiptaret, si Varese, i vlerësuar për pastërtinë, qetësinë dhe gjelbërimin gjithëvjetor, personalisht, jo pak kohe gjate javës, pranë librit në tërësi dhe atij artistik në veçanti. 4

## IRINA GJERGJI (DEMA), STILISTJA SHQIPTARE QË BEFASON FIRMAT PRESTIGJIOZE TË MODËS SË LARTË NË ITALI

Për ne ishte një befasoni njohja nga afër me një shkodrane, të cilën emigracioni nuk kishte mundur kurrë t'ia rrëmbente Shkodrës. E nuk ka se si një pasardhëse e denjë e familjes së nderuar Demaj, t'ia kthente shpinën vendlindjes së saj, pavarësisht suksesit që ka arritur në fushën e modës në Itali. Fama nuk e ka verbuar. Quket Irina Gjergji (Dema), dhe derisa u largua nga Shqipëria pas viteve 90-të, të gjithë këtu e njihnin si një grua duarartë që i përkiste një familje e cila ka nxjerrë rrobaqepëse të njohura si nënën e saj Kristina Dema, specialiste në atelienë "Moda" apo dhe hallën e Tiranës Roza Dema, modeliste dhe stiliste njëherësh. 5

## GJAMA E LEKË DUKAGJINIT PËR GJERGJ KASTRIOTIN MË PËRLOTI

**Dera Uneskos e hapur për ritualin më autentik iliro-arbëror - shqiptarë!**

Kur isha i ri ashtu si të rinjtë e sotëm e përçmoja si një ritual arkaik, që nuk duhej aplikuar. Sot kam e kuptoj, se ky mendim ka qenë mendjelehtësi e moshës.

Gjama e burrave vallja më epike, më dramatike nyje e pa zgjidhshme e të gjallëve dhe e të vdekurve, shkundlimë që ka drithëruar malet. Gjama e burrave vjen si jehonë e shekujve arterie jetëdhënëse e vazhdimësisë i iliro-arbëror-shqiptare, pa dyshim më autentikja, më vjetra dhe më e madhërishmja nder gjithë ritet e popullatave të Evropës plakë. Më gëzoi dokumentari special i Marin Memes dhe me këtë rast e përshëndes fort atë si gazetar, iniciatorin e tij, Gjon Dukë Gila dhe gjithë pjesëmarrësit. Për mua ishte gjetja më e mirë në kuadrin e 550 vjetorit të lavdiplotit Gjergj Kastrioti. Nëse sot, në mënyrë sporadike ky ritual ruhet në trajtë, shfaqet në agoni në malet e Dukagjinit, them se nuk është nevoja ti bej thirrje popullit të vijoj e të luaj gjamën e burrave, ndërkohë burra për gjame të tilla ka vetëm nder varre. 7

# VIT TË MBARË O SHKODER: POLITIKA E MIRË ËSHTË NË SHËRBIM TË PAQES

Këtë vit, më 09.01.2019, ora 17.30-19.30, Arqipeshkvia Shkodër-Pult dhe Komisioni "Drejtësi dhe Paqe" në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër dhe Teatrin "Migjeni" zhvilluan aktivitetin e përvitshëm "Vit të mbarë o Shkodër: Politika e mirë është në shërbim të paqes" që i referohet mesazhit të Atit të Shenjtë Françesk për Ditën Botërore të Paqes.

Moderatorët e mirënjohur të StarPlus TV, Ergys Kavaja dhe Emi Kalaja e hapën aktivitetin duke iu referuar motos së Shenjtërisë së tij Papa Françesku me mesazhin që i drejton botës për çdo fillim viti. Politika e mirë është në shërbim të paqes: mund të interpretohet si një këmbanë alarmi për veshët e atyre që popujt i kanë zgjedhur për tu prirë në rrugën drejt qëndrueshmërisë ekonomike të zhvillimit shoqëror dhe të bashkë-ekzistencës paqësore. Përgjegjësia e udhëheqësve politikë që bota po kalon është e padiskutueshme. Format e errëta, izolimi nga e ndryshmjia etj ndikojnë shumë në arritjen e paqes së dëshiruar. Ato mbjellin frikë dhe armiqësi mes njerëzve që pavarësisht nga ndryshimet kulturore kanë të njëjtat ëndrra dhe besojnë në të njëjtat vlera.

Aktiviteti u çel me një video montazh të shkurtër artistik me një përmbledhje të problemeve kryesore të vitit dhe kontributin e komuniteteve fetare në lehtësimin e tyre. Ndër të tjera u përçua që bashkëjetesa paqësore është pasuri për zhvillimin e harmonishëm të një populli. Më pas u ftuan në skenë për të performuar valltarët e Qendrës Baritore "Zoja Fatima" në Oblikë dhe ato të Famullisë "Zoja Ruzare" në Bardhaj, me motive popullore të Veriut, të cilët bënë një interpretim të mrekullueshëm. Skena u gjallërua më tej nga zëri i ëmbël i Aleksandra Rrotani me këngën "Fade it"

Pjesë të zgjedhura nga mesazhi i Papës u komunikuan gjatë shfaqjes nga ekrani në sfond në mënyrë të disa prej folëve dhe gazetarëve të dashur televizivë të StaPlus TV cilët përhapjen e së vërtetës e kanë pjesë të misionit të tyre të përditshëm. Në Insertin e parë u referua ndër të tjera: "Kërkimi i pushtetit me çdo kusht çon në abuzime dhe padrejtësi, politika është një mjet themelor për të ndërtuar qytetarinë dhe vlerat e njeriut por nga ata që e ushtrojnë nuk përjetohet si një shërbim për shoqërinë njerëzore, mund të bëhet vegël shtypjeje, mënjanimi dhe madje edhe shkatërrimi. Në fakt funksioni dhe përgjegjësia politike përbëjnë një sfidë të përhershme për të gjithë ata që marrin mandatin për të shërbyer vendit të vet, për të mbrojtur ata që banojnë aty e për të unuar që të krijohen kushtet për një të ardhme të denjë dhe të drejtë"

Aktiviteti vijoi me performancën e bukur Megi Toma me këngën "You raise me up" e ndjekur nga interpretimi i këndshëm i Martina Serreçi me këngën "Më fal"

Në vijim u paraqit përsëri një Insert tjetër nga mesazhi i Atit të Shenjtë Françesk: "Përkrah virtyteve, për fat të keq



në politikë nuk mungojnë veset që vijnë qoftë nga paafësia personale, qoftë nga shtrëmbërimet në mjedis dhe në institucione. Të gjithë e kanë të qartë se veset e jetës politike u heqin besueshmërinë sistemeve brenda të cilave ajo zhvillohet, ashtu sikurse edhe autoritetin moral, vendimeve dhe veprimet të personave të angazhuar". Të gjitha këto fjalë kuptimplote na bëjnë të reflektojmë shumë në ditën ndërkombëtare të paqes.

Programin e pasuruan dy këngëtarë të vegjël por mjaft të talentuar të



shoqëruar nga grupi i mrekullueshëm i valltarëve të Qendrës Kulturore të Fëmijëve, përkatësisht, Antonelo Zefi me këngën "Kameleon" dhe më pas Arseldi Muça me këngën "Treasure". Një kuptim jetik dhe domethënës përçoi drama e cila pasqyroi realitetin në familjet shqiptare nëpërmjet humorit dhe satirës. Nëpërmjet saj u dha mesazhi i qasjes së standarteve etike që duhet të ndjekim në jetë siç edhe u citua edhe nga folësit e dashur të medias vizive në Insertin e tretë lidhur me mesazhin e Atit të Shenjtë Françesk. Në skenë, më pas performuan valltarët e Qendrës Kulturore me një valle me motive të Shqipërisë së Mesme dhe Laurjan Ejlli me një potpori të këngëve shkodrane. Është për tu theksuar se duartroktijet nga salla nuk

mungonin asnjëherë pas performimeve emocionuese të artistëve të skenës.

Në Insertin e fundit të mesazhit të Atit të Shenjtë referohej se *paqja bazohet mbi respektimin e çdo personi, cilado qoftë historia e tij, mbi respektimin e së drejtës dhe të së mirës së përbashkët, të krijimit që na është besuar dhe të pasurisë morale që na është përçuar nga brezat e kaluar*. Në çdo insert, ishte i dukshëm mesazhi transparent që ka dashur të transmetojë Papa Françesku për të gjithë që të ndiejmë përgjegjësinë tonë dhe të veprimet si persona të përgjegjshëm.

Nën tingujt e bukur të Happy Days dhe Halleluja, e mirënjohura Rezarta Smaja animoi dhe elektrizoi gjithë sallën. Pas emocioneve pozitive që zgjoi interpretimi i saj, dy moderatorët e dashur të qytetit të Shkodrës, ftuan në skenë

Imzot, Angelo Massafra, At. Nikolla Petani dhe Zj. Voltana Ademi.

Në fjalën e tij, Shkelqësia, Imzot Massafra përshëndeti Mons. Maos i ngarkuar me punën në Nunciature, të nderuarën Kryetare të Bashkisë, Zj. Voltana Ademi, dhe At. Nikolla Petani, Zj. Loreta Aliko, Kryetare e Komitetit për Kultet, të gjithë të pranishmit dhe artistët e shfaqjes duke iu uruar Vit të mbarë o Shkodër e të gjithëve. Si fillim, falenderoi Z. Luigj Mila i cili është përgjegjës i Qendrës "Drejtësi dhe Paqe" dhe gjithë

shtesë, theksoi se Politika e mirë ka nevojë për persona të mirë, pikërisht sepse ajo është e mirë, nuk mund të jetë për gjë tjetër përveçse në shërbim të paqes për të mirën e njerëzimit. Në fund, e mbylli kumtesën e tij duke na bërë një thirrje që të jemi artizanë të Paqes.

Fjalën e mori At. Nikolla Petani i cili e nisi me një falenderim ndaj Zotit që u bë e mundur për të qënë të gjithë së bashku edhe këtë vit jo vetëm me fytyra të njohura por edhe me fytyra të reja, së dyti falenderoi Mons. Massafra dhe Kryetaren e Bashkisë që janë gjithmonë pranë me të mirat e problemet që ka qyteti jonë. Dhe së treti me zemër pohoi se *nuk është i aftë dhe nuk është në gjendje të interpretojë fjalët e Atit të Shenjtë pasi është një figurë e lartë botërore por si një mik e vëlla e të njohur që përshëndetim njëri tjetrin çdo ditë, të lutim Zotin që të mos kalojmë ato që kanë kaluar vitin e kaluar dhe të lutim Zotin për të gjitha të mirat që na jep, edhe për ata njerëz që kanë bërë mëkate në këtë vend dhe në fund lëshon një thirrje për të gjithë politikanët që të ulin tonet me qëllim për të patur një të ardhme më të mirë për fëmijët dhe familjet tona. Kur të gjithë së bashku kërkojnë të drejtën që e mendojnë të drejtë atëherë do mund t'ia dalim mbanë.*

Menjëherë e mori fjalën Kryetarja e Bashkisë, Zj. Voltana Ademi e cila fillimisht e emocionuar shprehu vlerësimin për aktivitetin dhe vlerat që ajo përcjell dhe theksoi se ne përballemi me probleme por gjithsesi duhet të gjejmë momentin që të reflektojmë për ndërtimin e një jete që ndërtohet mbi paqen. Më tej theksoi se besimi, pavarësisht fesë është një shtyllë e rëndësishme për të gjithë, pasi kishat dhe xhamitë nuk janë thjesht një simbol por thërrasin në emër të Zotit që të ndërtojmë jetën në mënyrë të denjë. Gjithashtu iu referua ndër të tjera thënies së Nënë Terezës "Nëse nuk kemi paqe, atëherë kemi harruar se i përkasim njëri tjetrit". Pra, shprehu se mesazhi ndërkohë i Papa Françeskut vjen për të gjithë ne, për drejtuesit, për politikën. Na bën të reflektojmë se politika e mirë është në shërbim të paqes dhe njerëzimit e mirë mund ta bëjnë këtë. Pra, le të jetë një reflektim për të gjithë, për ata që duan ta bëjnë këtë vend siç duhet." Në fund të fjalimit që mbajti, shprehu besimin se Shkodra mund t'ia dalë bazuar në vlerat e paqes, dhe punën e ndershme.

Në mbyllje të këtij artikulli, duke vlerësuar se ishte një natë e paharrueshme artistike, me një auditor të dashur që rrezatoi një kulturë bashkëkohore, ftojme secilin që të reflektojë thellë në vetëdijen dhe pavetëdijen e vet se politika më e mirë është të qënurit autentik me veten, në përputhje me vlerat universale që janë në dobi të njerëzimit: pra, vetëm në këtë mënyrë mund të kontribuojmë të gjithë për një vend me paqe.

**Përgatiti: Suella Ndoja**

# NATA TRADICIONALE - FESTIVALI BURIMOR "TREVA - 2019"

Tashmë është bërë traditë që ansambli folkloriko – kulturor “Treva”, në çdo fund viti të organizojë natën tradicionale, me krijimet më të mira të vitit. Edhe sivjet, me 24 dhjetor, u organizue veprimtarine e 16-të në prag të Krishtlindjes e Vitit të Ri, në tempullin e artit e kulturës, në teatrin “Migjeni”, nga shoqata kulturore – artistike “Treva”, me drejtuesit e saj kryesor, tashmë të afirmuar e të dashur për folkdashësit, zotërinjtë Fran Kodra dhe Ndue Shytani, në bashkpunim edhe me bashkinë Shkodër. Me të drejtë u quajt festival burimor, sepse u paraqitën pothuajse të gjitha krijime të reja të pandiguara më parë, duke e pasuruar krijimtarinë folklorike e artistike, duke i munguar vetëm çmimet për një festival me përmasa të mëdha. Këtu dolën të gjithë të fituar.

Duke u nisur nga emri i mirë që ka ky ansambl në bashkësinë dukagjinase e më gjërë, kërkesa për ta parë këtë veprimtari ishte shumë e madhe, edhe pse ishin ditë festash apo, se një pjesë e madhe e pjesëmarrësve të përvitshëm kishin emigruar, teatri u mbush plot e përplot. Ky ansambël promovoj në këtë manifestim të madh kulturor, këngët, meloditë e vallet më të bukura të vitit, pjesa më e madhe e të cilave ishin krijimtari të reja të kantautorit, kulturologut dhe të pashtershmit Fran Kodra, i cili në bashkpunim edhe me rapsodin e talentuar, Ndue Shytani, bëjnë një dyshe shumë të kërkuar dhe të dashur në të gjithë Shqipërinë e veriut. Ky festival burimor solli për shikuesit, të vjetrën tradicionale, të renë sociale në varg, të bukurën burimore në melodi dhe krenarinë tonë kombëtare në etnografi, duke na bërë kështu një dhuratë në këtë vundviti. Ky koncert u çel me një këngë për vendlindjen “Në Dukagjin” e kënduar nga i gjithë grupi, në të cilën, ndër të tjera theksohet: “Mos kujto se të harrova / çdo mëngjes me ty u zgjova / kurrë prej teje nuk u ndava / n'prehën tand ëndrrat i pava”.

Këngëtari i talentuar Admir Prebibaj, i cili vjen nga Italia enkas për këtë veprimtari, u paraqit me këngën “Kullat tona”, që, me interpretimin cilësor që i bëri mori duartrokitjet e të pranishëmve. Këngëtari nga Boksi, Zef Marku u paraqit me një këngë për vendlindjen e tij: “2 mijë vjet tokë ilirjane”, i cili, si gjithnjë i bëri një interpretim të mirë.

Këngëtari i talentuar, Remigjio Ograja u ngjit në skenë me një këngë lirike Dukagjini, duke pasuruar repertorin e këngëve. që i këndojnë të bukurës.

I përhershmi i kësaj veprimtarie dhe shumë i vlerësuar Gjovalin Shani, i cili vjet mori çmimin “Princ i folkut”, u paraqit me këngën “Lum kush rrin me burra t' mirë”, që, si gjithmonë, mori ovacionet e publikut. Gjeografia e repertorit të duetit të shumë kërkuar, Fran Kodra e Ndue Shytani është shumë e gjërë. Kësaj radhe u paraqitën me një këngë të re për Malësinë me titull “Kurrë nuk

ndahen shtatë malet e mija”. Nga forca e vargut dhe cilësia e interpretimit, morën vlerësimin maksimal të publikut. Emigranti shaljan, Pllumb Macaj, pinjoll i familjes Macaj nga Abati i Shalës, e cila është shquar për punimet me gurë e dru, e shëndriti skenën me punimet e tij në artin e gdhëndjes më dru, i cili është nderi i Dukagjinit, duke marrë disa çmime në Europë në ekspozita të ndryshme me skulpturat e tij.

Kjo veprimtari kulturore – artistike u zhvillue edhe në kuadër të 550 –vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriotit, kështu që nuk kishte si të mungonte ndonji krijimtari për Të, i cili për 25 vjet triumfoj ndaj një përendorie të tërë, duke u bërë luftëtar më i madh i Botës, për kohën dhe mbrojtës i krishtërimit. Për këtë figurë të madhe kombëtare u bë një këngë e interpretuar cilësisht nga

As kësaj radhe nuk mungoj humori nga të talentuarit Qazim Qela, Gac Kodrina (gaz e maraz) dhe djali i Boksit, Gegë Shpati. Kësaj here erdhën te publiku me një humor të ri larg banalitetëve, të cilët nëpërmjet tre figurave historike: Pashko Vasa, Mehmet Shpendi e Ded Gjon Luli fshikulluan të metat e mangësitë që tranzicioni ka shfaqur në vendin tonë. U duartrokitën si asnjëherë tjetër. Gegë Shpati interpretoj edhe një monolog humoristik mjaft afër realitetit. Në këtë natë folku e shëndriti skenën trupa e baletit nga Malësia e Tuzit, shoqëria kulturore “Koha” me drejtues artistik z. Sulo Beqaj, me regji të, të mirnjohurit Aldo Nika. Përveç valleve, të cilat ngritën peshë spektatorin, ata shoqëruan pothuajse të gjitha këngët duke dhënë shumë gjallëri. Bilbilja e këngës, Gofile Pappleka prezantohet nga moderatorja me vargjet: “Zemrat tuaja

ndër të tjera theksohet: “Kurrë mos thuej shqiptar fisnik / kur s'din fmija me folë shqip”.

Në luftën e Kosovës një djalë i ri shkodran ju bashkue U Ç K - së. Në betejën e Rahovecit mbeti i pavdekshëm në mes vëllezërve kosovar. Në majen e Rahovecit, në shenjë respekti për heroizmin e tij është ngrit një kështjellë, që mban emrin “Arjan Shkodrani”. Ky heroizëm, për 20 vjet mbeti në hije dhe, atë që nuk e bënë istancat shtetërore, e bëri Fran Kodra, i cili krijoi një këngë për Arjan Shkodranin, e cila u interpretua nga çifti malësor Blerim e Zuke Mataj, që ngjalli shumë emocion te spektatori. Shumë mbresëlënës ishte interpretimi nga shaljani, emigrant në Belgjikë, Fran Piniqi, i këngës së re të tij për Djelmninë e Shalës, me udhëheqës Memet Shpendin – Nderi i Kombit. Këngëtari tashmë i afirmuar e me shumë talent, Danjel Kopsaj u paraqit me këngën “Bukë e krypë prej duarve të nënës”. Një zë brilant nga Nikaj-Mërturi, Nikolin Përpali interpretoj, siç din Ai, një këngë epike për Ndoc Mark Dedën. Anëtar i denjëti i ansamblit “Treva” dhe kryetari i shoqatës kulturore “Bashkimi”, në Milano, Petrit Gjini, u paraqit me një këngë të bukur kurbeti me titull: “Amaneti i babës”.

Legjenda e vjetër e Halilit dhe Hajries vjen e përpunuar nga Fran Kodra, interpretuar në mënyrën më të mirë të mundshme nga kuarteti Kodra – Shytani – Çarku – Shqau. Një këngë e bërë enkas për muzikantin, këngëtarin e instrumentistin Roland Qukaj, nga zotni Frani me titull “A don a nuk don”, e pasuroj këtë koncert. Në këtë veprimtari artistike, i ftuari i përhershëm e special ishte z. Zef Beka, i cili me interpretimet e tij brilant, bëri për vete, si gjithmonë, një publik të tërë. Më i riu i grupit “Treva”, Kristjan Zalli, prej Gjurajve, me një zë të veçantë, sollti këngën “Pajtimi i brezave” e interpretuar cilësisht, i shoqëruar nga grupi, në të cilën thumbon brezin e ri të sotëm, në antipod me brezin e vjetër, që është një plagë sociale reale.

Jetë e gjallëri këtij aktiviteti i dha moderatorja, aktorja e talen-



këngëtarja Viola Shqau, që ndër të tjera theksohet: “Kush nuk e don Kastriotin / syni kurrë mos ja thaftë lotin /...” Edhe në Dukagjin, në shumë raste kënga trashëgohet nga brezi në brez. Kështu ka ndodh edhe me familjen Çarku, në Plan, ku e bija e këngëtarit të talentuar laurat i disa festivaleve Lekë Ndout (Plakut), Vera Çarku, sot nuse në Gjilan, u paraqit shumë denjësisht me këngën “Vendet e mija”.

me i çue peshë / ka folklori një princeshë / n' sofërt tonë një këngë me e nis / për trimneshat e Shqipërisë”. Një subjekt shumë i gjetur për heroinat në të gjitha trevat shqiptare. Interpretimi i saj na la pa fjalë, sepse ajo edhe me dashtë nuk din me këndue ndryshe.

Mbresëlënës ishte interpretimi i këngës “Kurbetxhia i vogël”, nga Emanuela Neçaj, nxënësja e shkollës së muzikës “Preng Jakova”, në të cilën



# URIMI IM PËR VITIN 2019!

Të nderuar miq të fjalës si vlerë universale! Këtu, nga Italia fqinje, ku po kaloj pushimet dimërore pranë fëmijëve, krahas kënaqësisë që më sjelle mjedisi kaq brilant i një qyteti kaq të preferuar, sidomos nga shqiptaret, si Varese, i vlerësuar për pastërtinë, qetësinë dhe gjelbërimin gjithëvjetor, personalisht, jo pak kohe gjate javës, kaloj pranë librit në tërësi dhe atij artistik në veçanti. Kjo ngjet, jo thjesht për të pare librat më të rinj që botohen këtu nga Shqipëria ime, që, kudo të jem në botë, jetoj i pandare shpirtërisht prej saj, por shumë më tepër se kaq, për të reflektuar ndaj atij folklorizmi, tashmë shumë banal, që vijon të komprometojë inkurajimin e letërsisë së vërtete artistike, si letërsi e madhe, në vendin tim. derivat i së cilës kemi edhe mungesën e pranisë së saj pranë lexuesit, sa të zakonshëm, sa atij të kualifikuar edhe në Perëndim, ndryshe si njeri nder kushtet thelbësore të së ardhmes sonë nga statusi i një vendi në zhvillim, sot, në të ardhmen, sa më të afërt, me statusin e një vendi të zhvilluar. Fjala është, se para disa vitesh, në njërin nga libraritë më serioze si "Mondadori", të cilën e frekuentoj gjithnjë me shumë kënaqësi, ngaqë aty kam "takuar", dy librat e Kadaresë: "La bambola" dhe "La provokazia", poet të atillë si Majakovski, veprën e të cilit nuk guxojnë as ta artikulojnë në ndonjë mjedis tonin universitar, nen ethe e antikomunizmit si dogme, botime të vitit 2018, dëshmi e vlerësimit të veprës së tyre nga botuesi italian, larg kultpragmatizmit banal, që dominon, mjerisht te botuesit tanë në përgjithësi, kur e ballafaqon me botimin po aq profesional, si të Dantes, poetit kombëtar italian, po në këtë vit, sikur kam takuar përkthime të ndonjë veprë të Kadaresë. Aspak rastësisht, besoj, nuk po e gjeja asnjë tjetër shkrimtar shqiptar, përveç Kadaresë, kandidat prej vitesh për "Nobel", të përmasave botërore. Kjo nuk do të thotë se po injorohet letërsia e jonë në tërësinë e saj, përjashtuar "Kadarenë", në Perëndim. Jo, jo fjala ime është diku tjetër. Natyrisht duke u përpjekur ta konsultoj me miq të ndryshëm, të diplomuar në Perëndim, që jetojnë me librin, të cilin këtu ta ofrojnë edhe në një mjedis kafeje për ta lexuar

fare lirshëm, bindesh se njëra nga frenatot tragjikomike, që sjellin mungesën e librit të ri shqiptar, është vete roli thjesht kultpragmatist, e cila fillon nga momenti që shtëpitë botuese, në vendin tonë, pajisen me licencën përkatëse të botuesit, i cili në këtë kontekst, thjesht për këto motive, nuk nënshkruan një kontratë me autorin duke i parapaguar vlerën financiare, pasi ka siguruar konkluzionin mbi statusin profesional të dorëshkrimit të librit, fale mendimit që ofron stafi i tij me shkrimtare apo kritike profesioniste, duke ia "besuar" gjithçka shaptilografit, ndryshe gjithçka mbyllet thjesht me likuidimin financiar, që i bën autori botuesit, pa ndjere në asnjë çast përgjegjësi për standardin profesional të librit, që do thotë pranimi i librit për botim vijon të motivohet thjesht nga numri sa më i madh i faqeve të pritshme. Kështu ne, po kultivojmë letërsinë masive duke vrare me vetëdijen tonë folklorike realizimin e vlerave universale, që meritojnë të inkurajohen brenda dhe jashtë vendit. Madje ky "privilegi" shaptilografist i ofrohet cilitdo autor, që di të shtype mbi tastierën e kompjuterit, për librin e të cilit kurrsesi nuk ka pasur në asnjë rast prononcime publike konfirmuese, si vlerë artistike universale, nga kritika letrare, siç ngjet në Perëndim, në mbyllje të promovimit të çdo krijimi vërtet artistik. Kjo nuk mund të jete ndryshe kur botimi

i një libri i ofrohet çdo kujt që paguan, sepse, me patjetër, kërkon ta shpalle veten shkrimtar.

Kultpragmatizmi i botuesit shqiptar, mjerisht, nxjerr krye edhe në lidhje me zhanret e gjinive të ndryshme letrare, sikurse edhe në parathëniet e improvizuara kundrejt vlerës komerciale të pretenduar nga autori i asaj parathënie, ku spikatin botimet e dorëshkrimeve me nostalgjia emigrantesh që, si kane gjetur vetveten ekonomikisht, kane llogaritur të mos humbasin "shansin" të veteshpalen shkrimtare, ndryshe persona publike e të tjerë e të tjerë. Një dukurie të tillë nuk po i shpetojne as shtëpi botuese serioze si "Onufri", që ka ekskluzivitetin e Kadaresë, duke iu shmangur standartit profesional të botimit të një libri, më sakte duke shpërfillur trajtimin nga grupi i vet i njohur me studiues, kritike letrar si dhe distributorin, shpërndarësin e librit për çka, "Onufri", është e vetmja si e tillë në Shqipëri, persa e kam njohur në rastin e bashkëpunimeve të mia, si autor libri, me këtë institucion deri në fillim vitet 2000..Nuk mund të jete garant i cilësisë së botimit ekskluziviteti as i Kadaresë, as i Qoses e të tjerë. por vetëm efikasiteti i fjalës profesionale nga ana e këtij grupi krijuesish profesioniste, i cili duhet ta thonë falen e vet, si "mamia" që duhet të shoqëroj ardhjen në jetën publike të një

libri të shëndetshëm, po e ritheksoj siç ngjet në Perëndim, nga pranimi i tij për botim e deri në promovimin publik profesional dhe jo preferencial me një apo disa shoke, që verdallosen, thjesht, për reklamim të vetvetes, të kompleksuar nga egoja e sëmurë, por kurrsesi nga vlerat profesionale të librit. Skandale të promovimeve jashtë standardi, larg shtëpive botuese të përgjegjshme ligjërish, ndryshe të pajisura me personel profesionale apo dhe të shoqatave të krijuesve të këtij profili, siç i përjetuam deri në vitin që kaloi, urojme të mos na shpifin në vitin e ri 2019 dhe në vijim, sikurse urojmë që pushteti lokal dhe qendror në Shqipëri, po e ritheksoj, ashtu siç veprohet në Perëndim, të motivohet seriozisht në nderimin e përvjetorëve të personaliteteve që i bëjnë nder bashkësive lokale, por edhe kombit tone, larg lojës së pastër për motive thjesht elektorale, folklorizma të llojit vetëm shqiptar, që do të komprometonin, në vijim, seriozitetin ndaj vëmendjes së librit të vërtete artistik në Shqipëri dhe jashtë Saj, NDRYSHE seriozitetin ndaj këtij ambasadori të mrekullueshëm të identitetit tonë sa lokal, sa kombëtar, siç konsiderohet libri artistik, në veçanti, në botën e qytetëruar.

**Kadri Ujka,**  
Varese, me 12 janar 2019



◀ tuar znj. Merita Smaja, e cila me paraqitjen e programit nuk meritë kërkënd me fjalë të tepërta, siç ndodh rëndomtë nga disa sofragjinjë. Në këtë natë të folkut Dukagjinas morën pjesë drejtues të pushtetit vendor me në krye kryetaren e bashkisë Shkodër, znj. Voldana Ademi, e cila vlerësoj grupin artistik të Dukagjinit dhe ju uroj të gjithëve Krishtlindjen dhe Vitin e Ri 2019.

Si çdo vit mori pjesë edhe presidenti i "Qendrës kombëtare të artit dhe kulturës shqiptare" z. Minella Kureta, i cili vlerësoj maksimalisht veprimtarinë e këtij grupi e sidomos drejtuesit e tij zotrinjët Fran Kodra e Ndue Shytani, të cilët i ngriti në pedestal. Kësaj radhe, Ai në emër të institucionit që drejton ju dha tituj vlerësues: znj Gofile Papeleka,

për interpretim mjeshtëror të folklorit dukagjinas e më gjërë, si dhe z. Roland Qukaj, si muzikant, këngëtar e instrumentist shembullor. Me gjithë vullnetarizmin e drejtuesve të këtij ansamli, kjo veprimtari nuk mund të bëhej pa mundësorët dukagjinas, dashamirës të folklorit, që ndër kryesorët ishin: shoshjano - amerikani, Ndue Ftoni, deputeti Tom Doshi; Martin Cubi, Nikollë Vuksani, Gjin Brigja, Shkëlzen Delia, hotel "Floga", Agim Dardha, Tom Arra, Gjekë Sokoli, Lin Gjeloshi, Aleks Plepi e të tjerë. Kjo veprimtari artistike folloi dhe u mbyll me këngën për Dukagjinin, që i gjithë grupi ishte në skenë me një pamje madhështore, me një panoramë shumë ngjyrëshe, që rezatonin veshjet kombëtare të traditës. Ishte një natë e paharrueshme folklorike, me një auditor që rrezatoj një kulturë për

tu pasur zili, duke treguar se sa fort jemi integruar në jetën urbane; me element të rinj burimor, duke na përcjellë arritjet në fushën e krijimtarisë e të interpretimit, duke e pasuruar thesarin e trashigimnisë kulturore e folklorike të Dukagjinit.

Kjo veprimtari artistike, kjo veprimtari e një ansambli folklorik dukagjinas, nuk mund të arrihej pa drejtuesit e këtij ansambli si: Udhëheqësin artistik Fran Kodra, drejtuesin organizativ Ndue Shytani, drejtuesin muzikor Luan Dakistani, regjinë dhe koreografinë e Ado Nikës.

Ky festival burimor do të ishte më i plotë e cilësor sikur të merrnin pjesë edhe disa këngëtar të tjerë të afirmuar dukagjinas, prej së cilës një pjesë janë vetpërgjashtuar për arsye subjektive e xhelozie; kurse ca të tjerë, sepse nuk kanë pasur

krijime të reja, të cilët kanë qënë mësuar që gjithçka të jua japin të gatëshme Fran Kodra, i cili nuk ka marrë as mirënjohjen nga ata.

Çdo veprimtari ka problemet e veta, kështu që edhe kjo kishte problemet e veta, por që ishin të papërfillshme në krahasim me suksesin, po të kemi parasysh edhe pamundësinë për të bërë prova paraprake. Mirë do të ishte me pas edhe instrumente të tjerë tradicional si: fyelli, zumarja, gjethja dhe në veçanti la huta.

Kemi besim të plotë, se në të ardhmen do të kemi veprimtari të tilla edhe më cilësore e gjithëpërfshirëse, duke e pasuruar më tej trashigimninë kulturore e folklorike të Dukagjinit e më gjërë.

**Përgatiti: Prelë Shytani**

# IRINA GJERGJI (DEMA), STILISTJA SHQIPTARE QË BEFASON FIRMAT PRESTIGJIOZE TË MODËS SË LARTË NË ITALI

Për ne ishte një befasi njohja nga afër me një shkodrane, të cilën emigracioni nuk kishte mundur kurrë t'ia rrëmbente Shkodrës. E nuk ka se si një pasardhëse e denjë e familjes së nderuar Demaj, t'i kthente shpinën vendlindjes së saj, pavarësisht suksesit që ka arritur në fushën e modës në Itali. Fama nuk e ka verbuar. Quket Irina Gjergji (Dema), dhe derisa u largua nga Shqipëria pas viteve 90-të, të gjithë këtu e njihnin si një grua duarartë që i përkiste një familje e cila ka nxjerrë rrobaqepëse të nderuara si nënën e saj Kristina Dema, specialiste në atelienë "Moda" apo dhe hal-lën e saj në Tiranë Roza Dema, modeliste dhe stiliste njëherësh.

Dhe ja tani pas afro 30 viteve, kemi një takim me Irinën, tek i cili nuk dimë se ku të përqëndrohemi më parë: tek koleksioni i saj i sapo përfunduar, apo tek arrijtjet në vendin e huaj, Itali. Në shtëpinë e saj në Shkodër, gjatë pushimeve dimërore 2018, sapo ka qepur rreth 50 fustane, xhaketa dhe pallto, një porosi kjo e një francezi. Ngriti një skuadër të vogël me rrobaqepëse shkodrane dhe eksperimentoi për herë të parë të krijonte pikërisht në vendlindjen e saj një koleksion të modës së lartë. Këtu kemi të bëjmë vetëm me kampionët, nëse do t'i quanim kështu, të cilat më pas do hyjnë në prodhim. Porositësi i tyre është një francez dhe ndryshe nga punimet e tjera, të cilat Irina ose Ina sic e thërrasin të gjithë, i ka realizuar në Itali, kësaj radhe zgjedhi që me një grup punonjësesh tepër të afta realizojë në Shqipëri këtë koleksion, përgjatë pushimeve dimërore që kaloi këtu. Edhe pse ajo ndjek gjithë procesin e qepjes, më së miri mund të quhet një stiliste e mirëfilltë, pasi një foto që vjen nga pala porositëse duhet zbërthyer dhe bërë llogaritjet para prerjes. Ata që janë specialistë të fushës, këtu do shohin një mrekulli, duke filluar që tek prerja e deri tek qepja perfekte në cdo detaj. Ngjyra dhe prerje të modës, në realizime që të bëjnë të humbasësh pas tyre. Veshje të punuara me kaq kujdes, sa bukurinë e skatësinë e qepjes nuk e kanë vetëm nga jashtë por edhe nga brenda. Bile disa veshje mund të vishen nga të dyja krahët. Për fat të keq në Shkodër, klientët vishen nga ajo që ofrojnë dyqanet. Përpjekja për tu dhënë hov stilistëve dhe sfiladave këtu mungon. Një realitet krejt tjetër ekziston në kryeqytet Tiranën, në një kohë që dhe Shkodra i ka kushtet për dicka të tillë, shprehet Ina.

Me sa duket, kjo ardhje e Inës do të pasohet nga plane më të mëdha në verë. Ajo po projekton që shtëpinë e saj në Shkodër ta kthejë në një Shtëpi Mode, e para për nga lloji në qytetin verior dhe

gradualisht edhe në ngritjen e kurseve për vajzat dhe gratë, duke u dhënë mësim mbi artin e bukur të stilimit. E për këtë e ndihmojnë jo vetëm eksperiencia ndër vite, por dhe studimet që ka kryer në Itali në fushën e modes. Por le të mësojmë më shumë rreth jetës së Inës, duke ndjekur trajtën e një biografie të shkurtër. Irina Gjergji është një vajze shkodrane. Me një nënë mjeshtre kuptohet që rritet një vajzë e frymëzuar për t'i hyrë dhe ajo rrugës së rrobaqepësisë. 5 vjece preu rrobdishamin e Kristinës, të së ëmës, dhe sajoi dicka për



vete. Me tej nuk u ndal në fantazinë dhe kurajon e saj. Në monizëm pati mungesa të shmta në gjetjen e dickaje të bukur për tu veshur. E nisi duke qepur rroba për veten dhe me pas rrethi i klientëve u zgjerua. Mes viteve 1986-1997 punoi fillimisht në qëndistari dhe më pas në Riparim-Shërbime. Asnjëherë nuk e ka ditur se çfarë do të bëhej me jetën e saj në të ardhmen. Me ndërrimin e sistemeve dhe mundësitë sfilatëse që dhanë eksodet e mëdha pas viteve 90, u hap një dritë jeshile edhe për Inën. Emigracioni do të niste fillimisht në Gjermani. Qëndrimi atje zgjati vetëm 2



vjet. Ëndrra e saj për tu bërë stiliste nuk gjeti hapësira në vendin e përmendur më shumë për zhvillimin e industrisë sesa të modës. Në Itali gjeti vetveten edhe pse hyri në prodhim, në ndërmarrjet e mëdha të rrobaqepësisë. Pas shpatullave të kësaj

gruaje pasionante dhe të aftë qëndron një burrë i devotshëm për ta mbështetur atë në cdo hap të jetës, Marjo Gjergji. Ka qenë pikërisht ai që e nxiti t'i futej studimeve për tu përgatitur si stiliste profesioniste. Në 2003 merr diplomën e Insitutit Callegari për modeliste, për zhvillimin e modeleve (svilupatrice) dhe organizimin e fazave të punës në prodhim. Duke e përforcuar këtë edhe me kryerjen e një kursi specializimi, me rezultate të shkëlqyera. Ishte koha kur ajo punonte dhe studionte njëherësh. "Castellani", "Bartolini" në

Perugia (1997-2001) ishin 2 fabrikat tek të cilat Ina ka punuar në prodhim të rrobave të firmave Prada, Dolce & Gabbana, Versace, Donna karan, Max Nara, Jil sander, Agnona, Gunex e Gucci. U shkëput nga realiteti i një ndërmarrjeje, që nuk krijonte hapësira të mëdha për të hyrë në artin e stilimit. Parësore ishte prodhimi dhe jo krijimi. Studioja e pare tek e cila ajo gjeti një vend pune ishte Brunello CUCINELLI (Perugia 2001-2003). Ndoshta hapi i parë serioz në karrierën e saj u shënuar kur u bë pjesë e Studio Roscini mes viteve 2003-2011. Gjithë eksperiencia e Irina Gjergjit si rrobaqepëse e modeliste në industrinë e modës përfshihet në 30 vite pune të palodhur, ku oraret mbeten thjesht

shifra të përshkuar nga akrepat e orës. Një pasion që të rrëmben, nuk i ndahesh dot, aktivizon gjithë qënien tënde, fantazinë dhe prodhon krijime të vecanta, të pëlqyeshme dhe konkruuese në tregun e modes, - kështu do ta vlerësonte veprimtarinë e saj Ina.

Nëse fillimet e para ishin stilime dhe qepje të thjeshta, vitet e eksperincës e praktikuan në modele të vecanta (të modës së lartë) për gra, burra e fëmijë. Aftësitë e saj të treguara bindshëm para eprorëve e kanë vendosur shpesh në rolin e përgjegjëses për projektimin e realizimin e fustaneve të provave, kampionëve të prodhimit. E këtë autoritet asaj ia dhanë stafet drejtuese të firmave të tilla si: ROBERTO CAVALLI, SCERVINO, RIBEIRO, PUCCI e STERNE INTERNATIONAL e DOLCE & GABBANA. Por momenti më i rëndësishëm në gjithë karrierën e saj është bashkëpunimi në linjën e modës së lartë të një ndër firmave më prestigjioze në botë Roberto Cavalli. Nuk mjafton vetëm dija e fituar. Njerëz të tillë lindin me ndjesi të larta në këtë fushë duke nisur që në thellësi të qepjes, në zgjedhjen e ngjyrave, të copave dhe aksesoreve. Vendoste shpirtin në cdo punë që bënte.

Në natyrën e Inës evidentohen menjëherë tiparet e një njeriu bashkëpunues. Nuk është aspak imponuese, dallohet

menjëherë natyra e saj si sygjeruese e një ideje të re në arritjen e një rezultati të kënaqshëm. Punë dhe studim njëherësh, kjo është motoja e saj.

Fustanet mbjanë gjithë sharmin femëror duke e bërë të shkëlqejë cdo femër që ka patur fatin t'i veshë. "Ina fashion" është studioja e saj në Itali, e ndërtuar mes viteve 2011-2018 në Perugia, vendi ku jeton sëbashku me familjen. Kjo i ka dhënë asaj pavarësi dhe autoritet në fushën e modës në Itali. Për stilisten Irina Gjergji, interpretimi i veshjes në një foto përmes patronëve të krijuar nga dora e saj, tashmë duket si dicka e thjeshtë. Duke njohur rregullat e qepjes dhe anatominë trupore, arrin të realizojë kampionë me përllogaritje matematikore, aq sa modelja që mban veshur punimin e saj ndihet sikur ka lindur me të.

Të gjitha koleksionet e krijuara, që e kanë zanafillën që në projektimin e prerjes e deri tek hekurosja, kalojnë në procese të gjata, në duart e disa punëtorëve të specializuara të një studioje, mbikqyerja e të cilave kërkon një eksperte mbi kokë. Dhe e tillë është Irina Gjergji.

Një jetë e ndarë mes studiove dhe pasarelave të modës, krijon Eksperiencia komunikimi dhe ndarje përvojash me modelet, stilistët, drejtorët e prodhimit e me modelistet e tjera. "Ne jemi të padukshëm, shprehet ajo. Merita zakonisht korret nga drejtuesit e firmave, për të cilat punojmë"

Në krijimet e saj vihet re loja perfekte me copat e holla, tepër të vështira për tu punuar dhe krijuar veshje të derdhura, që shtrihen këndshëm në format femërore. Mjeshtëria e saj është akoma më e dukshme në krijimin e xhaketave, palltove, etj.

Profesionistët e vërtetë kanë daluar saktësinë në prerjet dhe qepjet që realizon duke i ofruar që të punojë për Markat e rëndësishme; Fendi, Missoni, Trusardi, Bottega Veneta, Roberto Cavalli, Tom Ford, Tommy Hilfiger, Albino, Nina Ricci, Donna Karan, holston, Comei & co e Stella McCartney.

Gjithë ëndrra e Inës është të krijojë një linjë të vetën me emrin e saj. Nga ana profesionale ajo tashmë i ka të gjitha aftësitë

Në hapsirat mes sfiladave, ajo gjen kohë gjate pushimeve 1 apo 2 mujore që të merret dhe me pikturën. Në shtëpinë e Inës gjen disa piktura mjaft interesante dhe bashkëkohore.

Tashmë ajo ndihet një grua e realizuar në jetë, që gjithmonë ka një plan i cili e pret. Rrjetet sociale janë një kontakt më vete mbi risitë dhe burim frymëzmi. Qëndron në kontakt me bashkëkohoren dhe tendencat e modës. Ndërkohe jeta reale e pasarelave dhe e studiove i ka krijuar mudësinë e konkretizimit të atyre ëndrrave, që për shumicën do kishin mbetur thjesht të tilla. Por Ina është karakterizuar nga vullneti dhe këmbëngulja për t'i realizuar duke patur tashmë, një punë të mrekullueshme me të cilën krenohet.

**Përgatiti, Kozeta Bruçi,**  
Shkodër, më 9 janar 2019

# SHKODRA, SHTRON MBYLLJEN E MADHE TË VITIT 2018

Ditët dhe netët kalojnë një nga një, muajt dhe stinët pasojnë njëri-tjetrin dhe dalë nga dalë kalendari plotëson vitin që po lëmë pas, një vit që gjithmonë; ditë për ditë, muaj për muaj dhe stinë për stinë lë pas ngjarje të bukura, por dhe të hidhura në jetën e përditshme të një populli.

Fundi i këtij viti, apo mbyllja e një kalendari vjetor sfumon ngjarjet e trishtueshme dhe frymëzon njerëzit që kapërcimin nga një vit në tjetrin ta bëjnë sa më të gëzueshëm.

Këto festa të fundvitit i mbledhin njerëzit në sofra familjare, por dhe në sofra më të gjëra, që mund t'i quajmë sofra popullore. Qytete dhe krahina të mbarë Shqipërisë, Kosovës dhe të gjithë trevave ku jetojnë shqiptarë, deri në vendet ku kanë emigruar mbledhen thjesht për të gëzuar, duke shpalosur në këto sofra bujarinë e mikpritjen, mirëkuptimin e dashurinë, e mbi të gjitha trashëgiminë e saj nga brezi në brez.

Gjithmonë më ka frymëzuar edhe një sofër e thjeshtë, që është shtruar në shtëpitë tona, por sofra popullore që shtrohet në këto raste më ka bërë gjithmonë krenar, aq më shumë "Sofra Shkodrane", sofra e qytetit tim, sofra e një qyteti kaq të lashtë.

Unë kam përjetuar dhe e kam ndjerë veten shumë të nderuar dhe në sofra të tjera shqiptare në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi dhe Amerikë, por natyrisht më mirë e kam ndjerë veten në "Sofrën Shkodrane", ku mikpritës kam qenë edhe unë.

Më takon që të shkruaj me kaq pasion për "Sofrën Shkodrane" si shkodran që jam, por edhe ta përshkruaj atë, në këtë natë të magjishme, në këtë fundviti.

"Mbyllja e mirë nxen burra plot" thotë një shprehje e vjetër popullore, por "Mbyllja Shkodrane" është kaq e mirë sa zë përveç burrave edhe djem e vajza të reja, deri tek fëmijët, të cilët ia plotësojnë kësaj sofre trashëgiminë dhe vazhdimësinë.

Nga larg kishin udhëtuar për t'u mbledhur në këtë sofër edhe shumë bijë e bija që prej vitesh jetojnë e punojnë në emigracion, sepse askund tjetër nuk festohet e gëzohet më bukur se sa në shtëpinë tënde. Ato vijnë çdo vit me mall dhe ikin përsëri, por të lumtur dhe të çmallur me qytetin e tyre.

Ka dhe prej tyre që nuk vijnë thjesht për të qenë pjesëmarrës në këtë sofër, por që japin edhe kontribut, si këngëtarja shkodrane me banim në Zvicër, simpaticja Gentjana Tafili, e cila me zërin e saj të mrekullueshëm u bë pjesë e këtij aktiviteti.

Dhjetori është një muaj i ftohtë, por shtrimin e "Mbyllja Shkodrane" në traditën prej 18 vitesh të Agjencisë së Spektakleve "Jehona e Shkodrës" me president z. Xhelal Halili dhe nën kujdesin e "Unionit Artistik të Kombit Shqiptar" e ngroh gjallëria e mrekullueshme e pjesëmarrësve në këtë sofër.

Edhe në shtëpitë tona, kur shtrohet një tryezë në raste festash, ajo bëhet më e bukur kur ke të pranishëm miq dhe të ftuar.

E tillë ishte këtë vit edhe "Mbyllja Shkodrane".

Me kënaqësinë e tyre të madhe kishin ardhur ta nderojnë Shkodrën tonë këngëtarë e artistë të mrekullueshëm, nga Tirana, Prishtina, Shkupi, nga të gjitha trevat, si dhe nga Diaspora.

Kjo mbyllja tradicionale u shtrua në sallën madhështore të "Art Center Blue Sky" me president z. Gëzim Brahusa, i cili ishte kujdesur për të gjitha, ashtu si vetë ky institucion kulture e ka traditë.

Pas urimeve të mirëseardhjes, moderatorja aq e mirënjohur dhe e dashur, aktorja e Teatrit "Migjeni" Rajmonda Marku, ftoi të gjithë të pranishmit të ngrejnë një doli për festat e fundvitit, duke i uruar atyre, në emër të organizatorëve, jetë të lumtur

i Madh", i cili ishte edhe regjisor i këtij spektakli të mrekullueshëm, hyri në rrjedhën e tij edhe pse herë pas here devijoi nga improvizimet e të ftuarëve. Pavarësisht këtij programi, kornizat devijoheshin, sepse diku në një tavolinë dikush merrte mikrofonin dhe këndonte me pasion pjesën e një kënge, diku tjetër dikush thurte një bejtë e dikush tjetër tregonte një barcoletë.

Këngëtarët e mrekullueshëm të ftuar nga qytete dhe krahina të tjera, e ndjenë veten këtë natë shkodranë të vërtetë, por kjo nuk ishte një risi, pasi edhe në sofrat e shtruara këtu e 18 vjet më parë, për miq të tillë është kujdesur Agjencia e Spektakleve "Jehona e Shkodrës".

"Qejfi bahet me shkodranë" dhe as



në familjet e tyre dhe një vit të ri të mbarë e me suksese.

Në këtë atmosferë të mrekullueshme, nën tingujt e muzikës popullore, salla ushtoi nga zëri i mrekullueshëm i këngëtarit shkodran Adnan Bala dhe kështu të pranishmit në sofrën e shtruar bashkuan urimet, bashkuan zërin me këngët e bukura shqiptare, ngritën dollitë, duke sjellur emocione që vetëm në "Sofrën Shkodrane" mund të provohen.

Programi i përgatitur sipas libretit të aktorit të humorit Gëzim Kruja "Mjeshtër



mund të imagjinohet një sofër në Shkodër, atje ku pijet dhe mezet më të mira janë kënga e humorit.

Kështu me këngë e humor kjo sofër filloi dhe mbaroi gjer në orët e para të mëngjesit.

Po kthehem edhe një herë tek një nga elementët kryesore. Sofra ishte shtruar në një sallë që kishte humbur nocionin e saj si e tillë, sepse këtë natë ajo ishte një shtëpi e madhe mikpritëse, e ngrohtë dhe bujare, "Art Center Blue Sky", shtëpia e madhe e artistëve.

Programi në vazhdim kishte rezervuar për të pranishmit zërin e mrekullueshëm të mjeshtërve të mëdhenj të këngës Bujar Qamili dhe Mukades Çanga, si dhe këngëtarëve Adnan Bala, Orjeta Kelaj, Ben Goxhaj, Lirim Gjonbibaj, Xhina Zefi etj., këngët e të cilëve u gërshetuan me humorin e mrekullueshëm që sollën këtë natë mjeshtër e mëdhenj të humorit Gëzim Kruja dhe Zef Deda së bashku me grupin "Gaz e maraz", me humoristët Gac Kodrina dhe Qazim Çela.

Miq e ftuar, ashtu si gjithë Shqipëria, Shkodra i vë në "krye të vendit", e në këtë vend të nderuar "Sofra Shkodrane"

kishte vënë këngëtarin brilante të këngës shqiptare, miken e preferuar Eranda Libohova, por edhe këngëtarin simpatik Korab Shaqiri, djalin e këngëtarit të madh Ilir Shaqiri.

Në sofrën shqiptare shpalosen vlera tradicionale, historike dhe artistike të kombit tonë, duke manifestuar kështu pasuritë materiale dhe shpirtërore, prandaj edhe në "Mbyllja Shkodrane", si pjesë e kësaj pasurie, nuk kishte si të mungonte prania e "Unionit Artistik të Kombit Shqiptar", "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut" me president Azgan Haklaj "Mjeshtër i Madh", i cili i pranishëm në këtë mbyllja, vlerësoi punën e madhe që Agjencia e Spektakleve "Jehona e Shkodrës", por edhe të gjithë institucioneve shtetërore-lokale dhe kulturore-artistike të Shkodrës, bëjnë jo vetëm për mbajtjen gjallë të traditës, por edhe trashëgiminë e saj nga brezi në brez.

Këto vlerësime të këtij personaliteti të palodhur të kulturës shqiptare i ilustroi më së miri në këtë natë shkodrane pjesëmarrja e artistëve të rinj e të vjetër, por

edhe e të ftuarëve nga të gjitha trevat. Një moment që tërhoqi vemendjen e të pranishmëve ishte "Mirënjohja" që drejtoresha e Qendrës "Ndihe dhe kujdesi për fëmijët jetim të ushtarakëve" brenda dhe jashtë vendit, z. Marjeta Karaj i dhuroi producentit të "Sofrës Shkodrane z. Zhe-lal Halili, me motivacion: Për kontributin e dhënë për fëmijët jetim të ushtarakëve.

Këtë shkrim u përpoqa ta shkruaj jo thjeshtë si një artikull gazete, jo thjeshtë si një informacion, por si një përjetim, i cili edhe mua më solli shumë emocione dhe i mbushur me këto emocione edhe unë uroj artistët pjesëmarrës, uroj shkodranët dhe gjithë shqiptarët kudo që janë: "Gëzuar dhe për shumë vjet këtë festë dhe të gjitha festat që na bashkojnë!"

Shënim: Titulli ndryshuar nga redaksia e gazetës. Titulli origjial është: "SHKODRA SHTRON SOFRËN E MADHE"

**Nga RAMAZAN ÇEKA,**  
Dhjetor 2018

# GJAMA E LEKË DUKAGJINIT PËR GJERGJ KASTRIOTIN MË PËRLOTI

## DERA UNESKOS E HAPUR PER RITUALIN MË AUTENTIK ILIRO-ARBËROR - SHQIPTARË!

Kur isha i ri ashtu si të rinjtë e sotëm e përçmoja si një ritual arkaik, që nuk duhej aplikuar. Sot kam e kuptoj, se ky mendim ka qenë mendjelehtësi e moshës.

Gjama e burrave vallja më epike, më dramatike nyje e pa zgjidhshme e të gjallëve dhe e të vdekurve, shkundlimë që ka drithëruar malet. Gjama e burrave vjen si jehonë e shekujve arterie jetëdhënëse e vazhdimësisë i iliro-arbëror-shqiptare, pa dyshim më autentikja, më vjetra dhe më e madhërishmja nder gjithë ritet e popullatave të Evropës plakë.


Më gëzoj dokumentari special i Marin Memes dhe me këtë rast e përshëndes fort atë si gazetar, iniciatorin e tij, Gjon Dukë Gila dhe gjithë pjesëmarrësit. Për mua ishte gjetja më e mirë në kuadrin e 550 vjetorit të lavdiplotit Gjergj Kastrioti. Nëse sot, në mënyrë sporadike ky ritual ruhet në trajtë, shfaqet në agoni në malet e Dukagjinit, them se nuk është nevoja ti bej thirrje popullit të vijoj e të luaj gjamën e burrave, ndërkohë burra për gjame të tilla ka vetëm nder varre. Sot njerëzit e kulturës, artit, shkrimtarët, studiuesit, artistet dhe njerëzit që marrin përsipër të na drejtojnë duhet ta vënë në skenë, në mënyrën më të mirë të mundshme, ta dokumentojnë, transmetojnë

dhe ta paraqesin si vlerë, jo vetëm shqiptare, por e veçantë edhe në shkallë kontinentale. Pati disa diskutues, që me të drejtë përmenden, se gjama në diktaturë ishte e ndalur. Po sot në këtë liri pa limit, për hir të ashtuqajturit globalizëm dhe post modernizëm a na lejohet ta lëmë të vdesin?

## GJAMA E LEKË DUKAGJINIT PËR GJERGJ KASTRIOTIN MË PËRLOTI

Referencat e Barletit u bë realitet. Pa dyshim ishte nga gjamet më të mira popullore pasi kishte brenda dhe një ide artistike, më spektakolare se gjamet që kam parë pas viteve 90-të. Skenari i gjames së burrave duhet shkruar, korrektuar, luajtur dhe nga aktorët profesionalist më të mirë të koreografisë dhe teatrit dramatik. Ne mburremi për shumë valle shkëlqimtare, që kanë ndeze flakë skenat botërore. Atëherë perse nuk e luajmë vallen më autentike, që ka vlerë më shumë sa qindra studime empirike, për të gjetur fillin e pa shkëputur iliro - shqiptare ndërkohë që duhet pranuar se Albonlogjia jonë nuk ka mundur triumfojë absolutisht kundër tezave anti shqiptare, që këpusin qëllimisht damarin ushqyes të dy barkusheve të zemrës sonë nacionale

Në përfundim të gjamës së burrave nuk pash as nuk dëgjova kujt e grave,



ndoshta u ka kaluar, por unë them se duhet të ishte. Në mort kanë shkuar burrat dhe gratë, kujt e grave janë isoja përmblylëse e ritualit tragjik, për fatin të një djali apo burri që ka lindur nga një amazonë.

Edhe kështu edhe në mënyrë më të realizuar GJAMA E BURRAVE E KADERËN E HAPUR PËR NË UNESKO nëse, ne shqiptarët duam ta çojmë atje. Jam skeptik, mbasi kur nuk e pranojmë këtu si zor më duket ta çojmë atje.

Për mua rendësi primare ka mbijetesa

e sajë në memorie shpirtërore, shqiptare, pa u xhelozuar nëse është më shumë dukagjinase, kelmendase, pukjane apo mirditore. Ajo është një ikonë emblematike gjithë shqiptare dhe mijëra vjeçare.

Edhe një herë ju lumtë dhe mos e leni me kaq!

Prele Milani

## NGA UDHËHEQËS SEKTI - NË VRASËS MASIV



Jim Jones, një burrë simpatik dhe tërheqës, udhëheqës sektit, predikonte një përzierje idesh midis socializmit, dashurisë vëllazërore dhe barazisë së racore. Ai u ofroi të verferve dhe të shtypurve në Kaliforni, ushqim dhe shërbim shëndetësor falas. U siguroi gjithashtu edhe strehë të pastrehve si dhe integrim në jetën sociale.

Ashtu si gjithë sektet e tjerë, edhe ky sekt ushtronte forcë tërheqëse mbi njerëzit, të cilët ishin braktisur nga familja, shoqëria dhe kisha tradicionale dhe, që kërkonin pranim e ngushillim shpirtorë. Për pjesën më të madhe të antarëve të sektit, Jim Jones u bë figurë babai. Për gjithç-

ka, që ai kërkonte, ata i shkonin pas, pa hezitim.

Nuk zgjati shumë dhe idetë e tij prej fanatiku për religjionin dhe socializmin, u shndërruan në ide madhështie. Ai e mendoi veten Krishti i Rilindur dhe më vonë, vetë Zot. Ai u kërkoi simpatizantëve të vet bindje absolute ndaj tij. Ai që guxonte të braktiste sektin kërcënohej me vdekje. Jones nuk lejonte kurrësesi që autoriteti i tij të vihej në diskutim. Prindët nuk guxonin të protestonin, qoftë dhe njëherë të vetme, kur ai urdhëronte që fëmijët e tyre të kamxhikoheshin. Në përpjekje për ta forcuar pushtetin e vet, ai, bashkë me mbështetësit e tij, u çvendos në Amerikën e Jugut, në një zonë të mënjanuar, në Guyana. Me leje zyrtare ai krijoi atje një koloni, të cilës i vuri emrin Kolonia Johnë. Banorët e kolonisë, në letrat që u shkruanin të afërmëve të tyre në shtet e Amerikës, e krahasonin koloninë me kamp përqëndrimi. Në mes të natës, ata ngriheshin nga gjumi me alarm për të dëgjuar me orë të tëra fjalimet e zjarra të Jones mbi veten e vet – një art ky i trushplarjes. Kush nuk dëgjonte me vëmendje, dënohej me dhunime të mëdha fizike. Nëse fëmijët nuk tregonin dashuri dhe nuk qeshnin kur përmendej emri i tij, u vinin elektroskok në këmbë dhe krahë. Fëmijët që ishin shumë të shkathët, i fus-

nin në një pus të thellë ku flitej se ishte plot me gjarprinjë.

Por, edhe të rriturit nuk ndjeheshin aspak më mirë. Kush guxonte të kundërshtonte urdhërin mbyllej për ditë të tëra në një arkë druri përvëluese, si arkivol. Për të vërtetuar autoritetin e vet absolut, Jones, urdhëroi që gratë e martuara dhe vajzat e kolonisë, t'i bindeshin atij për çdo rast për seks. Ai, në mënyrë të fshehtë, e vinte në provë lojalitetin e simpatizantëve të tij: Ai u dha atyre një pije, të cilën ai e deklaroi të helmuar. Nëse do t'i besonin atij, atherë duhej ta pinin të gjithë dhe të martirizoheshin për çështjen e socializmit. Ata e pinë pijen dhe u bindën se nuk ishte e helmuar. Furnizimi i kolonis me ushqime dhe medikamente ishte katastrofal. Njerëzit vuanin nga uria. Megjithatë, marrëzia që e kishte pushtuar Jones, nuk kishte fund. Për t'i frikësuar të gjithë ata që mendonin ta braktisnin koloninë, e rrethoi gjithë vendbanimin me roje të armatosur. Të pakënaqurve u rekomandonte vetëvrasjen. Nuk kishin rrugë tjetër veçse t'i bindeshin atij. Nga tmerri ata i besonin genjeshtrat e tij. Shumë nga ata, nga propaganda e tij trushplarse, besonin se rikthimi në shoqërinë e korrumpuar amerikane ishte vetëvrasje.

Fundi u afrua kur kongresmeni amerikan, Leo Ryan, dha alarmin nga infor-

macionet e marra nga banorët të kolonis Jones, dhe u vu vetë në krye të një grupi inspektimi për në koloni. Në fillim ai u takua me të ashtuqajturit banorë të "lumtur". Kur shumë banorë të kolonis iu lutën që t'i merrnin me vete për në shtëpi, atmosfera ndryshoi komplet. Në kohën që ai po hypte në makinë për t'u larguar, u sulmua nga njerëz të armatosur. Kongresmeni, dy reporterë dhe një banor i kolonis u vranë. Menjherë Jones mblodhi banorët e kolonis për prediktin e tij të fundit. Ai i njoftoi ata për të vrasët dhe paralajmëroi se, simpatizantët e tij do të vdesin nëse provojnë të dorëzohen tek armiqet e tij.

Jones i urdhëroi të gjithë banorët që të pinin një pije të helmuar me zyankali. Ata që nguronin, i kërcënoi me armë. Thua se të gjithë banorët e kolonis e pinë pijen vullnetarisht. Të mbijeturit tregonin se nënat u fusnin fëmijëve të tyre të gjirit zyankali në gojë. Familjet lidheshin dorë për dorë dhe prisnin të qetë vdekjen.

Kur autoritet nga Guyana dhe Amerika shkuan në koloni, gjetën mbi 900 kufoma. Jim Jones, 46 vjeç, u gjet i vrarë, nga një goditje me plumb në kokë. U provua se ai kishte bërë vetëvrasje.

Perktheu, Lekë Imeraj  
shkrimtar dhe përkthyes

# SHËNOHET PËR HERË TË PARË, QË NGA NJË I HUAJ REALIZOHET NJË KRIJIM NË VARGJE PËR PLISIN E BARDHË SHQIPTAR

Nga Agron Isa Gjedia

Me datën 4 janar 2019, në qytetin Norrköping të Suedisë, pata një takim të organizuar me z. Ullmar Qvick, personalitet i letrave të shkruara dhe mik i dëshmuar i Shqipërisë, Kosovës dhe shqiptarëve në tërësi. Ai takim u realizua në prani të z. Fahredin Berisha, Kryetar i Shoqatës Shqiptare "Iliria" në Norrköping, dhe z. Asim Mala, me qëndrim në Suedi, kontributor i Shoqatës Mbarëkombëtare "Bytyçi", Tiranë-Prizren, dhe z. Agbel Gjedia, nxënës në Suedi.

përcaktimin e titujve e çmimeve të nderit", i pasuar përmes vendimeve të tjera, në kuadër të tetë- vjetorit të jetësimit të nismës së kësaj Shoqate që "Festa e Plisit të Bardhë" të shpallet si festë mbarëkombëtare, si dhe mbajtjes së Edicionit të 15-të të Festës së Bytyçit, por edhe shpalljes së vitit 2018 si "Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, si dhe vitit jubilar të dhjetë vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, me votim konsensual vendosi: Ta vlerësojnë z. Ullmar Qvick, nga qyteti Norrköping, krahina e Ostergotlandës, Suedi, Si njëri nga miqtë më të shquar dhe të nderuar të shqiptarëve, kulturës, dhe çështjeve të tyre në Gadishullit

Ilirik, me motivacionin: "I bazuar në parime universale të humanizmit ka arritur që përmes simpatisë dhe angazhimit të tij energjik, me një punë të shquar intelektuale, propagandistike, afirmuese, përkthimit të veprave cilësore të shkruara nga shqipja në Suedisht dhe anasjelltas, ka ndikuar jo vetëm që të shtohet simpatia e popullit Suedez për atë Shqiptar të Shqipërisë dhe viseve shqiptare në Gadishullin Ilirik, por edhe për integrimin e shqiptarëve që kanë emigruar atje, duke bërë të mundur që të çimentosen fort gurët themeltarë për një miqësi të përjetshme në mes popullit shqiptar dhe atij suedez". Pas vizitës që na sugjeroi të bënim në bibliotekën e qytetit, na udhëhoqi dhe na shpjegoi për skedarët e librave shqip që gjenden në fondin e asaj biblioteke, më pas na ftoi në një kafene, ku në një ceremoni të thjeshtë i dorëzuam titullin e dhënë nga ana e Shoqatës dhe po ashtu i dhuruam edhe librat: "Plisi i Bardhë, Emblemë Hyjnore e Shqiptarisë", me autor Agron Isa Gjedia dhe librin "Plisi i vargut tim", përmbledhje poetike vetëm për plisin me autor nga të gjitha viset shqiptare dhe Diaspora Shqiptare në Botë, si dhe numrin e 15-të të gazetës

"Bytyçi". Kurse nga ana e z. Ullmar Qvick, na u dhurua libri i tij voluminoz prej 503 faqesh, i përkthyer në shqip më titullin: "Më shumë heroizma se sa grurë", literatura e shkruar nga ana e tij në Suedisht dhe ajo e përkthyer në Suedisht që trajton Shqipërinë dhe Shqiptarët, botuar në Prishtinë në vitin 2013.

Në mes të tjerave nga ana e z. Ullmar Qvick, na u kumtua, se pak kohë më parë po ashtu në Norrköping zv. Ministri i Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, z. Besnik Fahredin Hoti, bashkë me disa nëpunës nga Ambasada, ishin kontaktuar për t'i dhuruar në Bibliotekën e Qytetit një shenjë falënderimi për punën e tij të gjatë për kulturën shqipe në Suedi, sikurse janë përkthimi i poezisë shqipe, puna me disa fjalorë Suedisht – Shqip

dhe Shqip – Suedisht, si dhe duke përkrahur në mënyrë të lloj-llojshme edhe mërgimtarët shqiptarë në Suedi.

Bëjmë me dije se z. Ullmar Qvick ka një biografi të pasur jetësore dhe kontribute për Shqipërinë, Kosovën dhe Shqiptarët në tërësi, të cilën do të gjejmë rastin për ta bërë publike për opinionin e gjerë. Pas asaj ndarje të përzemërt dhe mbresëlënëse, për mua ishin befasuese disa shënime, që më përcollli përmes internetit menjëherë pas asaj ditë, i cili në mes tjerash shkruante:

"Agron Gjedia, Me mirënjohje për nderimin e treguar në emër të Shoqatës Mbarëshqiptare Bytyçi, Juve personalisht dhe Shoqatës ju uroj punë të mbarë gjatë vitit 2019-ës. Më gëzoi fakti se në gazetën tuaj nderohet Anton Pashko. Kam botuar suedisht dramën e tij Gof. Tani u shtyp përsëri nën kujdesin e Sokol Demakut.

Po ashtu më gëzoi fakti se studiuesi Frrok Kristaj përmend në artikullin e tij edhe këtë përkthim timin (1996). Ullmar Qvick "As më pak dhe as më shumë, por kjo tregonte se ai e kishte shfletuar dhe lexuar menjëherë gazetën në fjalë. Por sikurse rezultoi pa vonuar ai i kishte lexuar edhe librat që iu dhuruan nga ana jonë dhe i frymëzuar dhe duke i vlerësuar ato, kishte realizuar menjëherë një krijim në vargje, i cili mbante datën 7. 1. 2019, ose 3 ditë pasi librat i kishin rënë në dorë për t'i lexuar. Krijimi i tij përmbajtësor titullohej "Këngë Nordike për Plisin e Bardhë", duke shënuar atë që një i huaj për herë të parë, të sjellë në shqip një krijim në vargje për Plisin e Bardhë Shqiptar, i cili si më poshtë vijon:

## KËNGË NORDIKE PËR PLISIN E BARDHË

*Me plis të bardhë luftuan  
për liri kundër armikut gjakatar  
Me plis të bardhë punuan  
për memëdheun, për një jetë të mbarë*

*Skendërbeu, Ded Gjo' Luli, Bajram Curr'  
Për besë, nder dhe burri  
Në luftë me armë nuk u dorëzuan kurrë  
Dhanë jetën për të shtrenjtën liri*

*Dhe sa ka vuajtur Nëna Shqipëri  
me të bijat e saj, trimëresha të heshtur  
Kur shkojshin burrat në luftë për liri  
luftuan gratë për bukë, për vatër,  
për fëmijë që të jetonin  
në një botë më të lumtur*

*Sa e gjatë rruga plot mundime!  
Sa e fortë besa e shqiptarit!  
Plisin e bardhë e nderoi një trime  
Shote Galica, të dimrit e beharit  
flijoi jetën për të shtrenjtën Shqiptari!*

*Plisit të bardhë ia dhashë këngën time  
E bardhë si bora jonë është Shqipëria trime  
Nga vendi nordik i borës ju shikoj  
dhe me fjalë të mira dua t'ju nderoj*

*Ju uroj punë të mbarë, suksese dhe gëzime  
Të mos shuhet flaka jonë për liri dhe përparime!  
Drejtësia është themel i jetës njerëzore  
Me bukë, kripë e zemër do të korrim fitore!*

**Veriori (Ullmar Qvick),  
më 7 janar 2019**



Shoqatën Mbarëkombëtare "Bytyçi", Tiranë - Prizren, pasi kishte miratuar një vlerësim për z. Ullmar Qvick, në pamundësi pjesëmarrje në një aktivitet në nderim të këtij miku të shqiptarëve, mbajtur kohë më parë në atë qytet ku ishim të ftuar, udhëtoi deri në vend për t'i dorëzuar vlerësimin e akorduar për të.

Shoqata Mbarëkombëtare "Bytyçi", Tiranë-Prizren, me aktin e saj Nr. 152, datë 26. 08. 2018, vendosi: "PËR VLERËSIMIN E NJË MIKU TË DËSHMUAR PËR POPULLIN SHQIPTAR".

Duke u mbështetur në rekomandimin që i ka ardhur Shoqatës, nga Qendra Kulturore Shqiptare "Migjeni" Borås –Suedi, në zbatim të kriterëve të përcaktuara në vendimin normues Nr. 12 datë, 16. 09. 2006, "Për



# “ÇLIRIMTARËT” E SHKODRËS PËRBALLË VIKTIMAVE SHKODRANE TË BOMBARDIMEVE NË 1913!



Ka plot varreza (vend varrime) ushtarësh të huaj në territorin shqiptar! Janë turq, serbë, malazezë, grekë, italianë dhe biles ka pasur dhe gjermanë e anglezë! Por kanë diçka, sepse janë në territoret shqiptare, të banuara nga shqiptarë, që flitet shqip dhe që në shumicën e rasteve kanë ardhur si pushtues dhe masakruer të popullatës shqiptare.

Ditët e fundit eksponentë serbë, malazezë, të organizmave nacional religjionare e “patriotike” të dy shteteve, nderuan ushtarët serbë dhe malazezë të rënë në rrethimin e Shkodrës në vitet 1912-1913. Ose më mirë në atë gjakderdhje masive të filluar në 1912-tën dhe të vazhduar deri në 14 maj të 1913-tës kur “Internacionali” i formuar nga austriakët, anglezët, italianët francezët dhe gjermanët, i nxorën jashtë duke zbarkuar në pontilin e Shkodrës! Askush, as unë që kam shumë shkrime dhe emisione për 1913-tën, nuk mund të jemi dakord që “ushtarët” të mos kenë një varr! Kjo sigurisht nuk është “kushtetutë e mendimit normal” timin dhe shumë si unë! Por ka një problem të madh kur eksponentë dhe historianë apo dhe njerëz të pushtetit malazez serb në nderimin që ju bëjnë ushtarëve pushtues të Shkodrës dhe Shqipërisë të konsiderohen (ushtarët) me arrogancë dhe krenari si - çlirimtarë të Shkodrës! Sipas atyre në ceremoni,

këto ushtarë kishin rënë duke “çliruar Shkodrën”! E kjo në historinë e qartë, duke derdhur gjakun jo thjeshtë të atyre që po luftonin - por sidomos të mijëra qytetarëve dhe fshatarëve të Shkodrës në masakrat e rrethimit 183 ditor në rrethimin tragjik të madh në historinë e Shkodrës martire! Arroganca dhe padrejtësia shkon deri aty sa ushtarë të tillë, që kishin vdekur duke luftuar me mbrojtësit e qytetit të konsiderohen “dëshmorë të çlirimit të Shkodrës”?! Kjo tani është e pafalshme, e pa tolerueshme si historikisht dhe politikisht! Për më tepër, nuk reagojnë në Shkodër për një “xhenaze” të tillë absurde, me shpallje heronjsh të ushtarëve të cilët kanë vrarë mbrojtës, janë vrarë në luftim për të pushtuar Shkodrën dhe që kanë qenë pjesë e vrasjes masive të qytetarëve të Shkodrës, me anën e bombardimeve më të egra të një rrethim në territoret shqiptare! Nuk reagon katedra e historisë në zhdukje nga universiteti, nuk reagojnë shoqata të ndryshme, nuk reagojnë historianë në Shkodër, nuk reagon bashkia e lodhur deri në sflitje politike e Shkodrës, nuk reagon pushteti qendror dhe për më tepër, japin leje për një ceremoni të tillë ku malazezë, serbë bëhen bashkë, për të fyer Shkodrën dhe heroizmin e saj, kundër barbarëve serbë dhe malazez në 1913-tën!

Vazhdojnë ta dinë dhe ta besojnë se “Shkodra është e tyrja dhe prandaj flasin për çlirimtarë”?! Mendojnë se e kanë çliruar nga turqit, që në fakt ishin sigurisht pushtues por u renditën kundër urdhrave të Portës për t’ia dorëzuar qytetin Cetinjës në vitin 1913. Nuk ka nevojë për shumë vërtetime mjafton të lexosh patër Gjergj Fishtën për këtë temë! Harrojnë se divizioni Zeta ka bombarduar me topat 155 obuz të dhëna nga serbët dhe Rusët, qytetin kudo, në shtëpi, xhami, kisha, spitale dhe ku kishte më

shumë njerëz! Harrojnë se malazezët dhe serbët me rrethimin e tyre, nuk e morën kurrë me luftë qytetin dhe pse qytetarët shkodranë vdisnin me shumicë nga uria dhe bombardimet! Harrojnë se i gjithë qyteti ishte kundra tyre, muslimanë dhe katolikë, duke e konsideruar sulmin dhe rrethimin një pushtim nga forcat e Malit të Zi dhe Serbisë! Harruan rezistencën heroike nga mbrojtësit si turq, po sidomos redifë dhe shkodranë apo banorë të zonave rreth saj, kundra një pushtimi që po vinte me vrasje! Ishte një shtet i vogël malazez, që me anën e ndihmës së Serbisë ushtarakisht dhe po ashtu Ruisë, apo dhe Greqisë me anën e transportit të serbëve - po luftonte me një qytet të vetëm! Nëqoftëse Janina ra menjëherë - Shkodra e madhe, gjigande në heroizëm dhe nga ku mund të fillonte “Lufta e Parë Botore” qëndronte!

Sot megafonave të njerëzve që vijnë të hanë dreka në Shirokë, për nderimin e “çlirimtarit të Shkodrës” u duhet thënë se ishin pushtues, të cilët lanë në betejë mijëra e mijëra të vrarë! I shkaktuan Shkodrës si popullsi nga bombardimi dhe uria 12.000 të vdekur. Prishën 1200 shtëpi sëbashku me shumë xhami e kisha! Bombarduan konsullatat dhe spitale! Ku shikonin flamurin e bardhë me kryqin e kuq, bombardonin duke vrarë dhe të plagosur dhe njerëz në rrugë, krejt të pa fajshëm! Këta ishin “çlirimtarët” e Shkodrës, të cilët vetëm dorëzimi me marrëveshje dhe tradhti i bëri të hyjnë në Shkodër! Harruan se vetëm nga sëmudjet dhe makabritetit i urisë, kanë vdekur kush e di sa njerëz, të cilëve një shumicë nuk i dihen varret në Shkodër! Kanë harruar të tillë “xhahilë” se nuk ka shtëpi shkodrane pa dëmtime, pa të vdekur dhe pa të plagosur apo të vdekur nga sëmudjet në atë kohë në Shkodër! Këta janë çlirimtarët, të cilët nderohen nga njerëz, që duan të luajnë

role nacionalistësh në kurriz të Shkodrës! E për më tepër, media i lejon, pushteti vendor i “vdekur i gjallë” në Shkodër i lejon, pushteti qendror pazarxhi po ashtu dhe shumë e shumë shoqata deprimente dhe vetëm për llafë në Shkodër po në këtë linjë! Nuk reagon dot sot patriotizmi shkodran dhe kjo është për të ardhur keq! Shumë keq! Jo për armiqësi të reja me Malin e Zi apo shtetin mik sot për në integrimin Europian, por për padrejtësinë që i bëhet historisë në këtë drejtim nga koka të nxehta atje dhe qytetarë të minoritetit këtu! Cetinja e vjetër ka mbetur gjithmonë një marrëzi e kërkesës për të marrë Shkodrën dhe pikërisht kjo po përsëritet nga emisarë provokatorë në Shkodër. Të rënë malazez dhe serbë në Shkodrën e viteve 1913-të kanë vdekur në luftën për mbrojtjen e Shkodrës nga sulmi i tyre sa idiot (kurrë nuk do ta merrnin dot) dhe kriminal për të marrë qytetin që nuk ju ka takuar asnjëherë! E kanë pushtuar dikur, por kanë dalë jashtë! Nuk kanë qenë dhe nuk do të jetë kurrë i tyre, por nostalgjia për një mrekulli të tillë, i bën të qajnë dhe të provokojnë me lejen e “batutaxhinjve dhe të barsoletaxhinjve në Tiranë dhe Shkodër”, duke gërvishur plagën e vjetër!

Po, kanë vdekur malazezët dhe serbët sepse ka pasur mbrojtës trima! Kanë vdekur me shumicë (edhe shumë nga familja e Knjaz Nikollës) sepse Shkodra nuk merret me luftë! Kanë vdekur se kanë merituar të vdesin, për “aventurën e tyre” për të marrë Shkodrën! Gjithmonë kanë vdekur në Shkodër rrethuesit e saj dhe si përfundim, ka ardhur koha e kanë dalë jashtë! Gjithmonë!

**Nga Besi BEKTESHI**

## LAHUTA SHQIPTARE NË MUZEUN E BRUKSELIT

Kushdo që viziton Muzeun e Instrumenteve Muzikore në Bruksel, krahas veglave muzikore nga e gjithë bota gjendet dhe “Lahuta Shqiptare”. Ishte iniciativa e Fran Kukaj, emigrant i brezit të dyte, ku babai i tij kishte ardhur para 60 vitesh nga Dukagjini në Belgjike. Fran Kukaj shpjegon për gazetën “Dukagjini” dëshirën që lahuta, e cila ishte dhe është pjesë e identitetit shqiptar nga vinte familja e tij, të ruhej në muze. Kështu, muzeu kërkoi që kjo vegël të mos pranohet nga një individ, por nga një shoqate. Artistët shqiptarë, që jetonin

në Belgjike, në bashkëpunim me Ambasadën Shqiptare e me personalitete të artit në Belgjike promovuan këtë instrument muzikor. Në këtë veprimtari të larmishëm, muzeut i dorëzohet Lahuta dhe libri “Lahuta e Malësisë” nga Gjergj Fishta. Për lahutën e eposit shqiptar folën profesor Kole Gjelogshaj, bashkëpunëtor shkencor në Universitetin e Lire të Brukselit dhe politologu Safet Kryemadhi. Ata kane shpjeguar për lahutën shqiptare si një in-



strument i vjetër popullor, e cila gjendet në Malësinë e Madhe, Shalë, Shosh, Nikaj- Mertur, Kir, Khan, Plan, Sume, Postribe, Shllak, Temal, Dushman, Toplane, Rranxat e Shkodrës, Kruje, Kosove dhe jashtë saj, si në Evropë e Amerikë. Lahuta përdoret nga burrat kryesisht e në raste shume të veçanta edhe nga gratë. Ajo është përdorur pothuajse në çdo shtëpi malësore gjate dimërimit, pranë oxhakut, por edhe në rast festash e dasmash.

Sot përdoret edhe në mjedise publike. Sipas kantautorit Fran Kodra, lahuta më e vjetër është gjetur në fshatin Gjuraj-Plan, e cila i përket periudhës 250 vjeçare. Ajo është e ndërtuar me dru verri, që rritet brigjeve të lumit Kir. Sot kemi mjaftë mjeshtër pop-

ullor, që e përgatisin këtë vegël muzikore, që ndërtohet në forma të ndryshme.

Edhe pse kjo vegël muzikore prej dy vitesh ruhet në muzeun e Belgjikës, në kryeqytetin e Evropës. Sot ajo vajton fatin e saj, vijon të ruhet në familjet Dukagjinase dhe trashëgohet brez pas brezi si një pasuri e pavdekshme, nëpërmjet së cilës gjuha shqipe nuk tingëllon askund më bukur.

Sot, lahutën duan ta vjedhin serbet, ta bëjnë pasuri të tyre në UNESCO. Lahuta duhet shpëtuar ashtu që të këndoje përsëri për shqiptarët. Ajo është instrument popullor, që shoqëron këngët kreshnike dhe përfaqëson arketipin më të lashtë të veglave kordofone me hark të kontinentit Evropian.

Shpesh lahuta është quajtur edhe instrument Etnik i Shqiptarëve, pra iu përket atyre.

**Zef Nika**  
Bruksel, dhjetor 2018

# E VËRTETA HISTORIKE SI RRËFIM EPIK

**Nga Lazër Stani**

Libri "Stërgjyshërit tanë në Epikën Historike, shekulli XIX" i Gëzim Ziles

Rose E. Lane (Rous U. Llein) në librin e saj të njohur "Majat e Shalës" (Peaks of Shala) tregon e mahnitur për një malësor të shkuar në moshë, që i flet me krenari për historinë e lashtë të shqiptarëve. Aleksandri i Madh, Aristoteli dhe shumë figura të shquara të lashtësisë epike, sipas tij, nuk ishin grekë, por ilirë. Pra, paraardhës të shqiptarëve, shqiptarë, siç njihemi ne sot. Rose Lane, duke e dëgjuar e mahnitur rrëfimin e tij, e ndërpret: "Po këto histori i kanë shkruar grekët. Janë histori greke. Ju nuk i keni të shkruara." "Ne nuk shkruajmë se mbajmë mend, ia ktheu malësori i moshuar. Grekët shkruajnë se nuk mbajmë mend".

Këtë rrëfim krejt të veçantë të shkrim-

ria e Shqipërisë të ngjajë me një galeri pikturash të falsifikuara, ku kopja origjinale është tjetërsuar aq shumë, sa edhe me imagjinatën më të fuqishme e ke të vështirë ta përfytyrosh. Në veçanti e paqartë, e mjegullt dhe e shtrembëruar, është historia e vonë e dy tre shekujve të fundit, kur duhej të ndodhte pikërisht e kundërta, të ishte më e qartë dhe më e dokumentuar shkencërisht.

Dy elementë thelbësorë të identitetit shqiptar iu bëjnë ballë kohërave të errëta: gjuha, të cilën e flasim, e që padyshim vjen si një nga gjuhët më të lashta që kanë pëshpëritur njerëzit mbi dhe eposi i kënduar në këtë gjuhë, i vlerësuar me çmimin europian "Europa Nostra" dhe i propozuar për t'u regjistruar si pasuri e trashëgimisë jomateriale e mbrojtur nga UNESCO.

Në kontekstin e trashëgimisë gjuhësore, albanologu austriak Norbert Jokl mendonte se "sido që të jetë mbetjet e trashëgimisë gjuhësore të gjuhëve të lashta ballkanike, ilirëve dhe thrakëve, janë të lidhura ngushtë me gjuhën shqipe". Dhe gjuha është dëshmia më e fortë e vazhdimësisë, nyja lidhëse e epokave historike nga pellazgo-ilirët e deri te shqiptarët. Gjuha më shumë se gjithçka tjetër, mbush atë zbrazëti që krijon faktografia historike. Informacioni i koduar në gjuhë ngjan me informacionin gjenetik, siguron vijimësinë dhe trashëgiminë. Nëse ne ia dalim të dëshifrojmë atë, atëherë mund të mësojmë shumë për të shkuarën tonë.

I njëjtë është edhe informacioni i ruajtur në epikën historike, që nga Eposi i Lashtë i Kreshnikëve, e deri në epikën e vonshme në shekujt e tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë.

Gëzim Zilja pas një pune këmbëngulëse, ka përzgjedhur dhe sjellë për lexuesin më shumë se dy mijë vargje të kësaj epike historike që i përket shekullit të XIX-të, vargje që lidhen me personazhe historikë të Rilindjes Kombëtare, kapedanë trima e të papërkulur, që të kujtojnë kapedanët grekë të Kretës të përshkruar me aq mjeshtëri, nga Nikos Kaxanaxis (Nikos Kazantzakis). Janë prijës popullorë, kapedanë syptrembur, që i kundërvihen pushtimit Osman, reformave dhe ligjeve të perandorisë si dhe sundimtarëve vendas, shëmbëlltyra të sulltanëve, po aq gjakatarë e mizorë, demonë të së keqes që ka mbizotëruar në hapësirën shqiptare gjatë gjithë shekujve të sundimit Osman. Këta kapedanë siç mbahen mend në vargjet epike, që me profesionalizëm i ka sjellë në librin e tij Gëzim Zilja, nuk luftojnë "as për mua as për ty, por për gjithë Shqipëri". Janë kapedanë trima si Zenel Gjoleka, Çausht Prifti, Tafil Buzi,

Marko Boçari, Rrapo Hekali, Bilbiletë, Kaçakët e Çamërisë, Hamzë Kazazi, Oso Kuka, dhe dhjetra të tjerë që janë përjetësuar në këngë, por edhe ngjarje dramatike, shkatërrime e masakra ndaj vendbanimeve shqiptare për çka, siç del nga libri i Ziles, rekordin e zi e mban Ali Pasha. Duke lexuar librin e Gëzim Ziles, ne arrijmë në përfundime të tjera nga ato që ka nxjerrë historiografia shqiptare. Në vargjet epike Pashai i Janinës përshkruhet si mishërim i pushtuesit, si një pasha barbar turk, pavarësisht origjinës së tij shqiptare. Njëpëmjet vargjeve të përzgjedhura nga epika historike, Zilja, në librin e tij, na krijon portretin e një pashai mizor, barbar e të pashpirt, autor i masakrave të përgjakshme të Hormovës, Kardhiqit, Sulit, të Nivicës, Bubarit, Shën Vasisë e Belushit, shfarosës të ngulimeve shqiptare që i kishin mbijetuar pushtimit të gjatë Osman. Në këngët epike të atyre trevave, siç shkruan Zilja në librin e tij, "Ali Pasha konsiderohet turk (turqëri) dhe rezistenca ndaj tij si luftë kundër pushtimit turk". Për ta dëshmuar këtë Gëzim Zilja ka sjellë në libër vargjet epike:

*"Manastir o Shën Triadhë  
Si nuk u tunde këtë radhë  
Po më le bënë hatanë?  
Në gjithë ata kapetanë  
Që me të pabesë i vranë  
Se nuk qasnë turqistanë".*

Ndërsa heroin e qëndresës së hormovitëve kundër Ali Pashës, Mitro Çausht Priftin, epika historike e përjetëson me vargjet:

*Çausht, biri i Marisë,  
Kapetan i Shqipërisë,  
Dhe Kasap i turqërisë.*

Pra Pashai mizor i Janinës, pavarësisht qëndrimit të historianëve të ndryshëm, nuk ka asgjë shqiptare, përkundrazi është shkatërrues dhe pengues i krijimit të etnitetit shqiptar, i ringjalljes së vetëdijes shqiptare. Këtë përfundim, që nxirret nga vargjet popullore, e përforcon edhe informacioni që jep Enciklopedia Britanike, ku shruhet se "Në kohën e Aliut, Janina ishte qendra më e rëndësishme e kulturës greke, sepse Aliu punësoi grekë dhe themeloi shkollë greke".

Ali Pasha, në informacionin që sjell epika historike, nuk është asgjë tjetër veçse një strateg, ekzekutues i strategjisë së zhdukjes së etnitetit shqiptar të hartuar nga Sulltan Mehmeti (Mehmet Pushtuesi siç njihet në histori), pas dështimit të tij për të pushtuar Krudjen: zhdukje fizike të këtyre "të pafeve" rebelë, zhdukje të gjuhës që flisnin Arbënit.

Të kundërt me portretin historik të Ali Pashës vijnë në libër portretet e kapedanëve popullorë, prijës të rebelimeve, që nuk i nënshtrohen sundimit Osman, por

si burra të nderit, luftojnë me "turqëri e turqistan", siç është rasti i Zenel Gjolekës, prijësit të shquar nga Kuçi i Vlorës, i cili u përfshi në lëvizjen kombëtare, pasi Tafil Buzi shprehu keqardhjen se si nuk u gjend një lab të merrte hakun e Beut të Vlorës, të vrarë tradhtisht nga valiu i Janinës. Është fjala për vrasjen e Ismail Bej Vlorës, gjyshit të Ismail Qemalit. Zenel Gjoleka, atë kohë djalë i ri, me nismën e tij hyn në çadrën e kaftanazit (zyrtar i lartë turk), e vret atë dhe i çon fjalë Tafil Buzit:

*Dërgoi Gjonlekë Spanoi  
Tafil Buzit të mi thoi:  
Kaftanazin e martoi  
Të shtata ia numëroi!*


Autori, duke i referuar epikës historike, shkruan se Tafil Buzi është ndër të paktët prijës të kryengritësve kundër reformave të Tanzimatit që shpalli botërisht se Shqipëria duhej të çlirohej nga zgjedha turke dhe të qeverisej nga shqiptarët. Një ndër aktet e para të kryengritësve është vrasja e sundimtarit turk, Veli Agai, që epika popullore e ka fiksuar me vargjet:

*"Tafili me kapedanë  
Me Zenel Gjolekën labnë,  
Ndë Grebene u ngren' e vanë,  
Të vrasin Veli Aganë.  
Veli Aga Grebeneja,  
T'u ngjinë nga penxhereja  
Plot me gjak tu mbush shilteja."*

Udhëheqës i mbi njëzet betejave Zenel Goleka do ta shfaqte gjeninë e tij ushtarake veçanërisht gjatë kryengritjes së viteve 1847-1848 kundër Tanzimatit. Në vargjet e epikës popullore, të cituara nga Zilja në librin e tij, thuhet:

*"Erriu shokë erriu  
Gjolekë mandileziu  
Ikni o turq se u përpiu."*

Pra në të gjitha këngët epike, që autori i ka përzgjedhur dhe interpretuar me kujdes nuk i këndohet bashkëjetesës së servitur nga historianët, por qëndresës deri në vetëflijmë. Ata që kanë bashkëjetuar me osmanët nuk janë pjesë e Historisë së Shqipërisë, por pjesë e historisë së pushtuesit. Historinë e Shqipërisë e bënë ata që qëndruan, nënat, që folën, mësuan fëmijët, e qanë shqip dhe djemtë e burrat që ngjeshën armët e qëndruan edhe pse beteja dukej e pashpresë, pra e bënë ata "ditëzinj, që nuk luftuan as për mua as për ty, po për gjithë Shqipëri", siç shprehet Epika Popullore. Këtë të vërtetë të madhe sjell para lexuesit libri i Gëzim Ziles, "Stërgjyshërit tanë në Epikën Historike, Shek. XIX". Dhe pikërisht për këtë, ky libër nuk mjafton të lexohet. Ky libër duhet të mësohet.



tares amerikane, po e sillja në mendje, ndërsa lexoja librin e Gëzim Ziles, "Stërgjyshërit tanë në epikën historike, Shekulli XIX", një libër që sjell një informacion të jashtëzakonshëm për ngjarje dhe personazhe të historisë, atë të ringjalljes së shpirtit shqiptar, pas shekujve të errësirës dhe shkretimit otoman, e që njihet ndryshe si "Rilindje kombëtare". Historia jonë e lashtë e deri në mesjetën e vonë, nëse përjashtojmë epokën e Gjergj Kastriotit, është e varfër në dokumente, e për këtë, e vështirë për t'u plotësuar si shkencë dhe kjo bën që rrënjët tona të lashta të na duken si të zhytura në mjegull, dhe nganjëherë jemi detyruar të mbështetemi në argumente jo bindës, të paktën për historianët profesionistë.

Dhe jo vetëm mungesa e dokumenteve, por edhe padija e keqpërdorimi i informacionit historik, diktati i ideologjive politike, fetare etj, kanë bërë që histo-

# QEMAL ATATURKU DHE “TURQIA MODERNE”

(Nga Gerhard Schweizer)

Mustafa Qemal Pasha... Gjithandej në Turqi, e shikon portretin e tij, në sheshet publike, në zyrat e qeverisë, në shkolla, në banka, në restaurante, në çajtoje, në pazare, madje, edhe në shtëpitë e turqve.

Asnjë politikan tjetër nuk citohet në Turqi aq shumë sa ai. Askush tjetër nuk mendohet aq modern për idetë dhe mendimet politike. Tek ne në Perendim, Mustafa Qemal Pasha është bërë i njohur me titullin e tij të nderit: Ataturk, „Babai i turqve“, të cilin e mban, zyrtarisht, që nga viti 1934.

Ataturku e qeverisi Turqinë që nga viti 1923, vit ky i krijimit të Republikës Turke, deri në vdekjen e tij, në 1938. Gjatë kësaj periudhe 15 vjeçare të qeverisjes së tij, ai krijoi ligjet, të cilat siç i mendonte vetë ai, ishin fillimi i rrugës së „Turqisë Moderne“.

Ataturku i shfuqizoi të gjitha rregullat social-fetare, të cilat ishin bërë forca sunduese prej më shumë se 600 vjetësh në Perandorinë Osmane dhe që, akoma edhe sot, ku më shumë dhe ku më pak, janë spirancuar në shumë vende islame të botës: Islamin si Religjion shtetrorë dhe Sharianë, si aksi i të keqes në jetën politike dhe sociale të vendit. Në vend të tyre ai instaloi format strikte të qeverisjes, sipas modelit perendimorë: Ndarje ratikale midis shtetit dhe religjionit, shfuqizim të plotë të pushtetshmërisë së institucioneve fetare, në gjithë jetën politike, shtetore dhe sociale të vendit. Ataturku, deri në vdekje, as që mendoj ndonjëherë se duhej të korigjonte gjë në këtë drejtim. Një reforëm të tillë, as që kishte guxuar kush ta mendonte deri në atë kohë, në asnjë vend islam të botës.

Për faktin se, reformat e Ataturkut, shkaktuan shumë tensione të ndryshme, në politikë, religjion, dhe kulturë, themeluesi i Turqisë Moderne, u bë njëherash edhe njeriu më i diskutueshëm. Megjithatë, asgjë nuk ndryshoi në statusin e ikonës së tij. Edhe ata që e mbështesnin në reformat e tij por, edhe linja e ashpër e fanatikëve që i kundërshtonin reformat e tij, në fund fare, ishin të bindur se, pa Mustafa Qemal Pashën, pas rënjes së Perandorisë Osmane, nuk do të kishte Republikë Turke të pavarur por, do të ishte një shtet i dobët, një koloni e varur nën qeverisjen e fuqive të huaja. Si vende kolonizatore të mundshme mendoheshin Anglia dhe Franca të cilat, pas Luftës së Parë Botrore, për interesat e tyre, kolonizuan vendet e Lindjes së Afërt, sipas marveshjeve dypalshe.

Për ne, është interesant fakti që, Ataturku, guxoi të ndermarrë reforma perendimore. Që në fillim ndodhemi para pyetjes, si është e mundur që, në vendin më islamik të botës, të shfaqet një revolucionar i tillë, kaq ratikal, i cili guxoi të ndertonte një status kulti, të padiskutueshëm? Kush ishte ai njeri i cili guxoi që,

si me tehun e shpatës, të ndante shtetin nga feja?

Mustafa Qemali u lind në Selanik me datën 19 maj 1881. Selaniku, një qytet verior i Greqisë, në atë kohë, banohej po aq nga grekët sa dhe nga turqit dhe ishte teritor i Perandorisë Osmane. Kishat dhe xhamitë, të ndertuara afër njëratjetrës, përbënin pamjen kryesore të qytetit. Në vitin kur u lind Mustafa Qemali, në Europën Juglindore, ishte vetëm një rryp i ngushtë toke nën qeverisjen e Sulltanit dhe Selaniku ishte qyteti kryesor i kësaj zone.

Djaloshi Mustafa u rrit me idenë se, edhe këtë copë teritor të ngushtë, Perandoria Osmane, do ta humbiste së shpejti.

Babai i Mustafait ishte nëpunës dogane dhe e ema, fshatare shtëpiake. Të dy prindërit e tij kishin pikpamje të ndryshme, fetare dhe politikosociale. Babai ishte me pikpamje perendimore ndërsa e ema ishte e rrenjëzuar thellë në traditat islame. Nëndrkohë që babai ngulte këmbë që Mustafai të shkollohej në një shkollë të stilit perendimor, e ema kundërshtonte me forcë dhe kërkonte ta dërgonte në një shkollë kurani, ku të mësonte kuranin përmendsh, në gjuhën arabe. Një kombinim i tillë, mendimi, babai i orientuar nga perendimi dhe nëna nga bindjet islame, ishte karakteristike për shumë familje nëpunësish në fazën e fundit të Perandorisë Osmane. Megjithatë, pushteti mashkullor, fitonte thuajse gjithmonë. Edhe në rastin e tij, kështu ndodhi.

Në vitin 1893, dymbëdhjetvjeçari Mustafa, shkon në shkollën ushtarake, në Selanik. Në shkollë, ai ra menjherë në sy të mësuesve, për aftësitë e tij të veçanta. Njëri nga mësuesit, për ta dalluar nga fëmijët e tjerë, shumë prej të cilëve mbanin emrin e rendomtë, Mustafa, mendoj një emër tjetër. Emri i ri duhej të përshtatej edhe me zgjuarsinë e tij të pazakontë. Më në fund mësuesi vendosi që ta therriste me emrin e dytë arab, „Qemal“ (Kemal) që do të thotë i „përkryer“. Që nga ai moment, Mustafain, të gjithë e therrnin Qemal. Më vonë, kur ai u bë i plotpushtetshëm, emri i tij Qemal, u njoh zyrtarisht, si mbiemri i tij. Mbiemri i tij gjeti përdorim edhe në politikën turke. Mbështetësit e gjeneralit dhe themeluesit të shtetit turk, Mustafa Qemali, u vetdeklaruan „Qemalistë“ dhe flisnin për „Revilucionin Qemalist“.

Në vitin 1899, Mustafa Qemali, shkoi në shkollën ushtarake të këmbësorisë, në Stamboll. Në shkollat ushtarake të perandorisë, mësohej gjuha franceze por, sipas urdhërit të sulltanit, nga gjuhët e huaja, duhej të mësohej vetëm terminologjia ushtarake dhe, asgjë më shumë. Mustafa Qemali, si „rebel“ që ishte, nuk u pajtua

me këtë urdhër, doli nga kontrolli i Sulltanit, e mësoi frengjishten me themel dhe filloi të lexonte literaturë filozofike, perendimore, kryesisht atë franceze, të shek. 19.

Mustafa Qemalit, nuk i pëlqente aspak kultura turke e të jetuarit. Ai mendonte si perendimor dhe dëshëronte të jetonte si i tillë. Nuk i intersonte fare se çfarë flitej në Kuran apo në institucionet islame të kultit për alkoholin. Pinte vazhdimisht raki, me oficerët e lartë dhe personalitetet shtetrorë, gjë kjo që e ndëshkoi shumë rëndë.



Në moshën 57 vjeç, vdiq nga ceroza në mëlçi.

Përseri tek 1899.

Oficeri i ri, Mustafa Qemali, ra në kontakt me lëvizjen „Turqit e rinj“, një lëvizje kjo nacionaliste e cila ishte kundër sulltanatit dhe kërkonte të bënte reforma ratikale, sipas modelit perendimor. Lëvizja mbështetej në tezat e qytetimit perendimor, shumë nga të cilat, Mustafa Qemali, i vuri në zbatim kur u bë president i Turqisë. Tipike është njëra prej tyre, e përdorur në një broshurë të Turqve të Rinj, në vitin 1913:

„Nuk ka civilizim të dytë. Civilizim do të thotë, civilizim perendimor. Dhe ky duhet të arrihet me çdo kusht, me hir a me pahir“.

Mustafa Qemali, ra në sy të shërbimit të fshehtë, si militant i lëvizjes dhe, e burgosën për disa javë, i dyshuar për veprimtari revolucionare. Pastaj, komanda e lartë ushtarake, e transferoi në shtabin e gjeneralve në Damask, si komandant i shtabit të armatës 5-së. Ky transferim, shumë më tepër, do të thoshte, paralajmërim për djaloshin rebel që, të hiqte

dorë nga idetë dhe veprimtaria revolucionare. Megjithatë, në Damask, ai mori kontakt me lëvizjen „Turqit e Rinj“ dhe u antarsua në lëvizje. Në lëvizje bënin pjesë shumë oficerë të cilët ishin kundërshtarë të regjimit reaksionar të Sulltan Abdyl Hamidit II. Tre vjet më vonë, lëvizja organizoi puçin në Stamboll kundër Sulltanit dhe, në vitin 1909, Abdyl Hamidi II ra nga pushteti.

Mustafa Qemali, si oficer madhor që ishte, nuk bënte pjesë në qeverinë e re për faktin se, politikisht, që në fillim, nuk ishte dakort me nacionalizmin e theksuar të lëvizjes.

Në vitin 1916, në kohën e Luftës së Parë Botrore, Mustafa Qemali, pas gradimit gjeneral, mori titullin Pasha. Ai drejtonte frontin e luftës në Anatolia kundër rusve dhe palestinezve dhe, në Dardanele kundër trupave angleze.

Gjenialiteti i tij si gjeneral në frontin e luftës, nuk kishte asnjë vlerë për një shtet i cili ishte zhytur në korrupsion dhe mjerim. „I sëmuri i Bosforit“ (Perandoria Osmane), ashtu siç e mendonin evropianët që në mesin e shek. e 19. ishte shtrirë për vdekje. Humbja në Luftën e Parë Botrore, kundër trupave aleate, angleze, franceze, italiane, ruse, greke, jo vetëm që i dha fund perandorisë më të madhe të botës por, përzuri nga pushteti edhe turqit e rinj.

Deri në atë moment, Mustafa Qemali, ishte afirmuar si një figurë historike anësore. Ora e madhe për atë do të vinte pas rënjes së Perandorisë Osmane dhe konkretisht, dy vjet pas mbarimit të Luftës së Parë Botrore.

Me 10 gusht 1920, në Sevres (Versajë) të Parisit, midis aleatve fitues të luftës dhe Sulltan Mehmetit të VI, i cili e qeveriste vendin që nga viti 1917, u nënshkrua traktati i paqes. Perandoria Osmane humbi gjithçka. Sipas traktatit, nuk do të kishte më Turqi por, vetëm një bërthamë turqish, të sikterisur diku në Anatolia dhe gjithë pjesa tjetër do të ndahej midis fituesve të luftës. Edhe Sulltan Mehmeti i VI. e nënshkroi traktatin.

Si kundërshtar i flakët i Traktatit të Sevres, doli në skenë Mustafa Qemal Pasha. Sulltani nuk kishte gjë për të thënë. Ai, në kundërshtim me firmën dhe urdhërin e Sulltan Mehmetit Vi, u vu në krye të trupave turke, për të shpëtuar Turqinë. I bëri thirrje popullit dhe ushtrisë për mosbindje ndaj „Qeverisë tradhtarë“ të Sulltan Mehmetit. Nga luftimet e përgjakshme, prej tre vitesh, në krye të ushtrisë turke, ai arriti të rikthente shumë teritore Turqisë dhe i detyroi fuqitë e Mëdha që të mblidheshin për një traktat tjetër për paqe. Me 24 korrik 1923, në Lozanë, turqit nënshkruan traktatin e ri të paqës

# VARREZAT GREKE DHE GOZHDA E NASTRADINIT

Si ku do në botë edhe tek ne ka varreza të ushtarëve të huaj, rënë në luftëra të ndryshme. Kjo nuk bënë asnjë problem. Pasi ato përqendrohen në vende të miratuara, falë marrëveshjeve të bëra nga shtetet përkatëse. Në Shqipëri janë varreza të disa shteteve, si ato Gjermane, Franceze, Italiane e të tjera. Po jo në vende provokuese të shpërndara në disa zona siç pretendojnë grekët. Madje ku ka e ku nuk ka minoritete Greke. Akoma më e rëndë është fakti, se këto varreza janë bërë objekt pelegrinazhi, madje edhe provokuese, siç ndodhi kohët e fundit në Bularat.

Nuk dua të ndalem, se për këtë ngjarje është fol e fol, mjaftë pa asnjë vlere. Akoma më e rëndë është, se nuk po dihet e vërteta, se kush është autori e kush është viktima. Kjo, sepse shteti i jonë reagojë me shumë vonesë. Pasi qarqet nacionaliste Greke hodhën vrer ndaj shqiptarëve, duke na lënë fajtor, duke qenë në të drejtën e zotit, se kush ngre armën ndaj policisë, kjo e fundit do ti përgjigjet me të njëjtën monedhë.

Flitet, se dikur Nastradini shiti shtëpinë, po me kusht që blerësi ta lejonte me ngulë një gozhdë në mur. Blerësi ishte i mire dhe ja lejojë. Nastradini shëtiste poshtë e lartë dhe sa here vinte e varte strajcën në gozhdën e vet. Ditën, natën,

kur i tekej. Këto veprime e mërzhiten pronarin e shtëpisë. Kur durimi arriti kulmin, pronari i shtëpisë i thotë Naster: “Kam vendosur me ta kthyer shtëpinë, se na ke mërzhitë!” Po, Nastra me një indiferentizëm deri në neveri i përgjigjet: “Parat i kam prishë dhe nuk ua kthejë më. Po, ju t’i kishit pas mentë në kokë herët, tujë e ditë se kush është Nastradini!”

Kjo është aktuale për të gjitha qeveritë gjatë periudhës së kësaj periudhe, se duhet të vepronin me mendë në kokë në fillim. Duke e ditë se kush është nacionalizmi i thekur grek. Mendojë se normalisht grekët mund të kishin tërhequr eshtrat e ushtarëve grek të rënë në Shqipëri dhe të preheshin në varrezat e të parëve të tyre, siç kanë vepruar Italianët me ushtarët e rënë në vendin tone. Ndërsa Greqia nuk i luajti nga vendi, pasi Athina zyrtare vijoi ta quaj Jugun e Shqipërisë prone të saj. Në diskutime dëgjon komente nga më të ndryshmet. Një në mes të tyre thuhet, “Kur kanë rënë ushtarët grek këto 28 vitet e fundit apo në vitet 1940 deri në vitin 1941? Pse nuk i kërkuan eshtrat e të rënëve në këto për masa më herët e vendosjen e tyre në atë shpërndarje gjeografike?” Mendojë, se as në ëndërr nuk i kishin pa. Madje tani çdo ditë vjen duke u shtuar oreksi. Nuk jemi kundër të kërkuarit e të gjeturit të eshtrave të ushtarëve të rënë në luftë. Nderimi ndaj të rënëve është kul-

turë dhe nderim qytetar. Po nuk është me vend grumbullimi i tyre nëpër manastire të ndërtuara në tokën Shqiptare. Pas ngjarjes në Bularat, në Greqi ndodhën disa vrasje të shqiptarëve. Po edhe këto vrasje ishin në vazhden e qindra vrasjeve të tjera të ndodhura në shtetin Grek. Racizmi ndaj shqiptarëve nuk ka munguar asnjëherë. Këto veprime të tyre ata i manifestojnë edhe në token tone, gjatë pelegrinazheve, duke stisur ndonjë shkak, për të kujtuar Verio- Epirin si prone të tyre. Po ne, pse heshtim? Pse nuk ua themi troç, se kufijtë e Shqipërisë janë vendosur një here në vitet 1912, 1913. Ne kemi filluar të zbehim edhe çështjen Çame, kundrejt tyre pati një gjenocide të pa pare. Shpesh herë në takime zyrtare, Çamëria as nuk përmendet. Qofsha i gabuar, por dyshojë se pushtetarët tone ndaj grekëve tregojnë një servilizëm politikë. Po të kthehem rreth 30 vite më pare. Pikërisht në vitin 1985, kur u bë marrëveshja mes dy qeverive me komisione të përbashkëta, rezultojë, se në Shqipëri kishte rreth 2 200 varre të ushtarëve grek të rënë në luftërat e zhvilluara në vitet 1940-1941.

Qeveria e asaj kohe ra dakord dhe lejojë qeverinë Greke për tërhequr eshtrat e ushtarëve të tyre. Pala greke nuk e pranoi këtë mundësi të dhënë nga qeveria Shqiptare, se mendjen e kishin te Verio-Epiri. Pas viteve 90-të, lëvizjet e popullsisë kanë qenë masive. Të bënë përshtypje, se shumë familje kanë tërhequr eshtrat e të afërmeve të tyre, për ti rivarrosur në vendbanimet e reja. Ndërsa grekët nuk e kanë pranuar atë opsion të dhënë nga qeveria e asaj kohe Shqiptare. Përsëri të shkon

mendja te ajo gozhdë. Tani bëhet fjalë për 1 200 varre të ushtarëve grek të rënë në tokën Shqiptare!!! Këto të shpërndara në 8 rrethe të Shqipërisë Jugut. Janë bërë rreth 67 marrëveshje në mes të dy vendeve. Dëshira për një fqinjësi të mire ka mbet vetëm një dëshirë. Punojnë e jetojnë në Greqi rreth një milion shqiptarë. Punojnë në punët ma të rënda dhe paguhen më pak. Edhe pse quhen emigrantë ekonomik. Nuk kanë të drejtë pensioni. Për arsye të ndryshme këto ditë unë takova shumë emigrant shqiptar. Shumica e tyre që mu dha mundësia e takimit, ishin nga Dukagjini, zone nga e cila vije dhe unë. Ndonëse ishin njerëz të shkolluar e të integruar në jetën dhe kulturën greke, përsëri quheshin qytetar të dorës dytë.

Ngjarja e Bularatit e ka tensionuar akoma më shumë situatën. Pra këto kohë janë vrarë 4 shqiptare të pa fajshëm. Megjithatë duhet përhëndetur veprimi i policisë së shtetit, e cila nuk lejoj 200 persona të pa dëshiruar për vendin tone të hynë në Shqipëri me rastin e 40-tave të varrosjes së trupit të Koçias.

Nuk mund ta mbylli shkrimin pa u ndalë te titulli i këtij shkrimi. Për të mos e lejuar Nastradinin të na prishë qetësinë, kohë e pa kohë. Të shikohet mundësia e grumbullimit të eshtrave e të rënëve në një vend ku të shihet më e arsyeshme. Të paktën për ata, të cilët gjoja nuk janë gjetur akoma, ose të tërhiqen eshtrat e tyre e të rivarrosen në dhe të vet.

Përgatitur nga  
Ndue Ziçi

ku, ndër të tjera, Turqisë iu rikthyen teritorët e humbura, u njoh si shtet sovran dhe i pavarur. Gjeneral Mustafa Qemal Pasha hyri në histori si “Babai i turqve”.

Ky shtet i ri turk, në vitin 1923 u shpall republikë. Me 29 tetor 1923, parlamenti zgjodhi Gjeneral Mustafa Qemal Pashan president.

Ai e filloi punën me reformat ratikale, me përmbysjen e tipit të shtetit islam, i cili kishte sunduar me shekuj me rradhë. Ai e orientoi republikën e re drejtë kulturës dhe stilit perendimor.

Mustafa Qemali, si president i parë i Turqisë, trashëgoi një mjerim të plotë të vendit nga paraardhësit e tij. Do t’i duhej të rilindte një popull që nuk ekzistonte. Për qindra vite, turqit, kishin harruar se ishin turq. Ata e mendonin veten thjeshtë popull që flet turqisht, midis shumë popujve të tjerë, brënda miletit shumëkombësh të Perandorisë. Turqit dhe bashkë me ata, grekët, armenët, kurdët, arabët, ishin identifikuar si osmanë, në përbërje të miletit shumëkombësh të Dinastisë Osmane. Gjuha turke nuk ishte gjuha zyrtare. Ajo përdorej krahas shumë gjuhëve të tjera si, arabishtes, persishtes, greqishtes, armenishtes, kurdishtes etj. I „Sëmuri i Bosforit“ kishte vdekur duke lënë pas vetëm rrenojat e perandorisë. Rreth 80 per qind e popullsisë jetonte në fshat dhe, rreth 90 per qind ishin analfabetë.

Ataturku, nga paketa e madhe e reformave që do të kryente, fillimisht zgjodhi ndatryjen e shtetit nga religjioni.

„Politikani i cili kërkon ndihmën e religjionit, nuk është gjë tjetër veçse një budalla“, kështu do të shprehej ai lidhur me

qendrimin ndaj fesë.

Ai mbylli institucionin më të lartë islam, “Scheish -ul-islam”.

Në vitin 1926, miratoi ligjin sipas të cilit, shtetasit turq, të besimit musliman, lejoheshin të ndërronin besimin sipas dëshirës së tyre. Asnjë shtetas musliman turk, nuk do të ekzekutohej dhe as denohej më me burgim, nëse ndërron besimin fetar.

Religjioni do të mbetej thjeshtë si një çështje private, jashtë zyrave të shtetit. Kjo ishte në përshtatje me kushtetutat perendimore. Ataturku, në vitin 1928, e shfuqizoi ligjin kushtetues, sipas të cilit, religjioni ishte, shtetror. Ai ishte i orientuar si laicist dhe për një Turqi laike, sipas modelit francez. Ndaloj mësimin fetar në shkollat shtetore dhe mbylli shkollat e Kuranit. Në vitin 1932, sipas dekretit të tij, në institucionet e kultit, shërbesat fetare dhe lutjet do të zhvilloheshin vetëm në gjuhën turke. Nga ana tjetër, ai shprehë respekt ndaj besimit islam por, gjithnjë i ndarë nga shteti:

“Ne jemi të mendimit se, religjioni, i cili shekuj me radhë u shfrytëzua si vegël e politikës, duhet të çlirohet nga politika dhe të ngrihet aty ku i takon. Ne nuk duhet që shenjtorët tonë dhe besimin e shenjtë t’i përdorim si vegla për qëllimet tona politike”.

Eshtë e vështirë të thuhet nëse, ai e ndjente me të vërtetë atë që thoshte për islamin apo, ishte një taktikë e tij për të fituar besimtarët fanatikë islam të cilët ishin të shumtë. Vetë ai, që nga viti 1924, ishte shkëputur përfundimisht nga besimi islam.

Në vitin 1926, ai zëvendësoi alfabetin arab me atë latin, duke e prezantuar si, alfabetin e popullit. Shkollat shtetore, të tipit perendimor, u bënë të detyrueshme, për vizat dhe djemtë. Në programet mësimore, leike, u futën edhe gjuhët e huaja si, frengjisht, anglisht, gjermanisht.

Paralelisht, ai udhëhoqi reformat, në të gjitha fushat e jetës. Nuk kishte rrugë tjetër. Kjo domosdoshmëri diktohej nga kriza e gjithanshme që kishte mbërthyer vendin.

Për Ataturkun, nuk kishte rrugë tjetër për të ndaluar marshimin e perendimit mbi Turqinë veçse reformimit të vendit, sipas modelit perendimor dhe, atë bëri ai.

Një pjesë shumë e rëndësishme e paketës së tij reformuese ishte vlersimi dhe çlirimi i gruas nga obskurantizmi islam. Në kushtetutë u vu paragrafi, ku thuhej: *Burrat dhe gratë, kanë të njëjtat të drejta. Shteti detyrohet që, të marrë të gjitha masat, për të siguruar barazinë gjinore.*

Në vitin 1926 hyri në fuqi „Ligji për të drejtat civile“ i cili ishte ndërtuar në ngjashmëri me atë zviceran. Nuk kishte më Sharia. Sipas ligjit të ri, ndalohej poligamia, njohu të drejtën martesore si normë, u jepte grave të drejtën e prishjes së martesës dhe të drejtën e kujdestarisë për fëmijët. Gratë gëzonin të drejtën e trashëgimisë, njëlloj si burrat. Haçpi tjetër i rëndësishëm ishte kapitulli mbi të drejtat politike të grave. Në vitin 1930, gratë turke gëzuan të drejtën e votës në pushtetin lokal. Në vitin 1934, parlamenti u dha të drejtë grave për të votuar për pushtetin qendror dhe për t’u zgjedhur

në parlament. Një gjë e tillë ndodhi para Francës (1944), Italisë (1949), dhe Zvicrës (1971). Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1935, 18 gra fituan mandatin e deputetit.

Ataturku donte t’i tregonte popullit turk se, si duhet të jetë gruaja moderne turke. Ajo duhej të xhvishej nga uniforma e islamit dhe të vishej europiançe, duhej të ngjitej në tribunë dhe të ishte kudo në jetën e vendit, njëlloj si burrat. Vajza e tij e adaptuar, Sabiha Gökçen, mbaroi akademinë ushtarake dhe, në vitin 1936 u bë polotja e parë luftarake në botë.

Ataturku, i cili krijoi pa kompromise një shtet laik të tipit perendimor, nuk mendoi edhe për një kushtetutë demokratike. Në vitin 1923 ai e organizoi republikën turke si shtet njëpartiak, me partinë Popullore Republikane (*Comhuriyet Halk Partisi*), të cilën e krijoi vetë. Ataturku, si udhëheqësi i kësaj partie të vetme e njohur me ligj, në princip, ishte diktator. Garantia për pushtetin e tij ishte ushtria, të cilën e kishte krijuar vetë. Detyra e parë e gjeneralve ishte, mbrojtja e Kushtetutës Republikane, për çdo rast dhe nga çdo rrezik.

Ataturku, vitet e fundit të jetës i kaloi në Sarain Dolmabahçe, në Stamboll. Aty vdiq me datën 10 nëntor 1938. Trupi i tij qëndroi për nëntë ditë dhe nëntë netë në sallonin e pritjes, ku u nderua nga qindëra dhe mijëra turq.

Përktheu: Lekë Imeraj  
shkrimtar dhe përkthyes

# UJI, ZJARRI DHE MORALI

Patën një periudhë, që ata u mërzhitën me popullin e tyre. Populli ishte vesves, ters dhe kryeneç. Diskutonte keq e i shpërfillte në çdo gjë. Secili prej pjesëtarëve të tij turfullonte me tjetrin, pa ndjenjën e tolerancës. Kështu vepruan edhe në një Kuvend sqarimi me ujin, zjarrin e moralin, se pjesëtarët e popullit ishin sherrxhinj e donin t'i dëbonin.

- Mos, - i tha popullit **zjarri**, shumë i nevrkosur. - Mos, se unë, po ika, nuk kthehem më te ju! Vetëm në ndonjë pyll do me shikoni, duke përpirë gjethet e degët e tij te thata kapote blerta.

Populli qeshi dhe nuk ia vuri veshin kësaj fjale. Zjarri iku e ata (populli) e

panë vërtet nga larg duke përpirë pyllin.

- Do vemi ta marrim, - thanë pjesëtarët e tij. - Kemi gabuar ndaj zjarrit.

Dhe thonë, se morën farën e tij, pas një hezitimi të gjatë ...

Por nuk e patën mire punën me **ujin**. E shpërdoronin, talleshin e hidhnin ndaj njeri-tjetrit ujë me grushte, e shanin.

- Mos, - u tha uji, - se po ika nuk kthehem më, si zjarri. S'do më gjeni dot. Do futem thelle në tokë!

S'e besoj këtë gjë populli, dhe vijoi me mospërfillje ndaj ujit.

- Po uji, i mërzhitur shumë, iku nga sipërfaqja e tokës e u fut thellë në tokë. Populli ulëriti, se s'duronte dot pa te. Plasi nga etja, për pak ditë. Pjesëtarët e tij gulço-

nin e shfrynin ndaj vetes për gabimin me jetën e tyre- ujin. Ku nuk e kërkuan, po nuk e gjeten. Vendosen të gërmonin tokën. Thellë, thellë, e, më në fund, gjeten një pusët me ujë. Si u shndriten sytë kur e panë! Gërmuan e gërmuan, e, si e lanë të madhohej, i vunë çikrik e nxorën në sipërfaqe. Tashme çdo pike të tij e puthnin më parë se ta pinin! "Kemi gabuar shumë, -thoshin me njeri-tjetrin kokulur, - na fal o **syri-qelibar i jetës!**"

Por, duke qene vesves, populli mërzhiti edhe moralin. E shanin kot, e qesëndisnin, nuk e përfillnin. Por morali, në kulmin e inatit të tij të kristalste, ia pat popullit:

-Rri urtë, se, po ika, nuk më gjeni dot më, si zjarrin dhe ujin. - Ah, unë një fjalë kam e se kthej dot më. Nuk do më gjeni, sikur dhe tokën e qiellin të bëni bashkë.

Nuk e besoi populli e vijoi sharjet e tij prej vesvesi

Dhe thonë, se morali iku, me të vërtete. Ku nuk kërkoj populli: në det, në tokë, në qiell. Gërmoi brenda vetes, - në token dhe qiellin e ndërgegjes. Pa me përcëlim, kujtoi me brengje, po moralin nuk e gjeti më.

-E shihni?-thanë për një gojë zjarri e uji. - Ai s'u kthye, si ne. Ne u treguam zemërgjerë.

Moralit s'i dëgjohej kurrkund triva (gjurma) e zëri. Populli pa te mbeti si kufomë, meit (figurativisht i vdekur) i verdhe, e s'i vërshëllente kush.

Marrë nga një kallëzim  
Ndue Sanaj

## \*\*\* KURIOZITETE \*\*\* KURIOZITETE \*\*\* KURIOZITETE \*\*\* KURIOZITETE \*\*\*

### DISA KURIOZITETE PËR NEPTUNIN, PLANETIN ME ERËRAT MË TË SHPEJTA

Neptuni është planeti i tetë në Sistemin Diellor. Është emërtuar sipas Neptunit që ishte Perëndia e detërave dhe ujit te rrjedhshëm. Neptuni është planeti i tetë për largësinë nga Dielli në Sistemin tonë Diellor. Ai është planeti i katërt më i madh nga diametri dhe i treti më i madh nga masa. Neptuni peshon 17 herë më shumë se masa e Tokës.



Sipas astronomëve, Neptuni ka erërat më të shpejta në Sistemin Diellor. Erërat në sipërfaqen e Neptunit mund të arrijnë deri në 2100 kilometra në orë. Shkencëtarët ende nuk e kanë përcaktuar arsyen.

### PËR ÇFARË E PAGUAJNË ANGLEZËT FAMILJEN MBRETËRORE?

Në vitin 1697, Parlamenti Britanik kishte caktuar 1.2 milionë sterlina në vit për familjen mbretërore, si fond në kohë paqeje, me të cilat ata do të paguanin monarkinë si dhe nëpunësit civilë, (gjykatës e kosto të tjera), ndaj dhe emri

"Lista Civile".

Por mbreti Xhorxh III, që erdhi në fron në vitin 1760, ashtu si dhe paraardhësi i tij, Xhorxh II, nuk arrinte t'i mbulonte të gjitha këto shpenzime, ndaj bëri një marrëveshje me parlamentin.

### MBRETI XHORXH

Marrëveshja ishte që monarkia t'i dorëzonte parlamentit pronat e trashëguara, bashkë me të ardhurat, dhe si këmbim parlamenti do të mbulonte pagesën e Listës Civile. Megjithatë, pronat mbeten edhe sot në emër të monarkisë, edhe pse nuk i menaxhojnë dot.

Prona që përjashtohet e që nuk do t'i jepej parlamentit, por do t'i mbetej familjes mbretërore angleze, ishte Dukati i Lankasterit. Ndërsa Dukati i Kornuollit i mbetej princit të Uellsit.



Lista Civile ndaloi së quajturi e tillë në vitin 2011, kur mori emrin Granti i Sovranit.

Mbreti Xhorxh III nuk paguante dot shpenzimet, ndaj bëri marrëveshje me parlamentin që të dorëzonin pronat mbretërore, bashkë me të ardhurat, e si këmbim të paguheshin nga buxheti i parlamentit.



### POR SA I KUSHTON FAMILJA MBRETËRORE SOT TAKSAPAGUESIT ANGLEZ?

Financimi i drejtpërdrejtë për të mbuluar shpenzimet zyrtare të monarkëve britanikë jepen nëpërmjet "Grantit të Sovranit", që zëvendësoi "Listën Civile" në vitin 2012.

Ky fond rishikohet çdo pesë vite.

Në vitet 2016-2017, Granti i Sovranit ishte rreth 48 milionë euro. Në vitin 2018 shkoi 86 milionë, për shkak të rimobilimit të pallatit Buckingham.

Mbështetësit e monarkisë thonë se kjo pagesë është rreth 1 euro në vit për çdo person në Britani.

Megjithatë, kjo nuk përfshin kostot për sigurinë dhe kujdesin ndaj familjes mbretërore.

Një grup mbështetësish të republikës thonë që shpenzimet për mirëmbajtje shkojnë në rreth 115 milionë euro në vit, me një kosto totale shpenzimi prej 400 milionë eurosh.

### A MUND T'I SHPENZOJË FAMILJA MBRETËRORE PARATË SIPAS DËSHIRËS?

Jo, 48 milionët që merr nga buxheti janë për funksione zyrtare, bamirësi, kopshitari, udhëtime jashtë vendit, etj.

Por mbretëresha, princi Çarls dhe disa anëtarë të tjerë të familjes mbretërore kanë të ardhura të tjera, nga pronat private që nuk ua dorëzuan parlamentit.

Mbretëresha merr rreth 20 milionë euro në vit nga pronat që zotëron në atë që quhet Dukati i Lankasterit.

### A PAGUAN TAKSA FAMILJA MBRETËRORE?

Që nga viti 1992, mbretëresha e Anglisë ka ofruar me dëshirë e saj të paguajë taksa mbi të ardhurat private, të cilat nuk përdoren për funksione zyrtare.

Princi Çarls gjithashtu ka paguar taksa mbi të ardhurat për pronën e tij, Dukatin e Kornuollit, që në vitin 1993.

Në vitin 2011, për rreth 25 milionë euro të ardhura ai pagoi rreth 5 milionë euro taksa.

### ÇFARË FITIMESH I SJELL FAMILJA MBRETËRORE BUXHETIT TË TAKSAPAGUESVE?

Anglia pret rreth 2.7 milionë vizitorë që vijnë vetëm për të parë vendet që kanë lidhje me familjen mbretërore. Sipas llogaritjeve, të ardhurat nga turizmi i lidhur me familjen mbretërore janë rreth 2 miliardë euro në vit.

Veç kësaj, familja mbretërore i shton të ardhurat shtetit duke ndërhyrë si ambasadorë për të lidhur marrëveshje biznesi. Me këtë thuhet se i shtojnë buxhetit rreth 170 milionë euro në vit.

Këto shifra janë shumë herë më të larta se çfarë paguajnë taksapaguesit për të mbajtur familjen mbretërore.

### NJIHUNI ME NJERËZIT MË TË ÇUDITSHËM NË BOTË!



Dikush që luan futboll duke pasur 3 këmbë, binjakë që kanë jetuar dhe si kanë folur kurrë askujt përveç njëri tjetrit, një tjetër burrë që kishte 24 personalitete. Të gjithë këto kanë qenë njerëz dhe kanë ekzistuar dikur, ndonëse para kësaj ne i kemi parë vetëm si personazhe fiktivë nëpër përralla.

### "NJERIU I PYJEVE"- PETRUS GONSALVUS

Të gjithë e dinë historinë e "E bukura dhe bisha", të cilët u dashuruan me njëri tjetrin. Por shumë pak e dinë që kjo his-



tori ka ndodhur vërtetë dhe personazhet kanë jetuar. Gjithçka nisi në 1537-n, në Tenerife, ku lindi një fëmijë jo i zakonshëm. I gjithë trupi i tij ishte i mbuluar me flokë. Prindërit mendonin se djali kishte një çrregullim të shkaktuar nga djalli dhe kur mbushi 10 vjeç, ia shitën atë piratëve francezë. Ata e quajtën “Njeriu i pyjeve” dhe e prezantuan me mbretin e Francës, Henri II. Ky i fundit, vuri ri se djaloshi ishte shumë i shkathët dhe inteligjent. E shkolloi, e edukoi dhe pasi mbreti vdiq, gruaja e tij u kujdes për të, derisa e martoi me zonjushën e bukur të quajtur Catherine.

**FUTBOLLISTI LEGJENDAR, FRANCESCO LENTINI**

Ai lindi në Itali më 1889-n. Thuhet se ai do të kishte një vëlla binjak, por diçka nuk shkoi siç duhet dhe trupi i vëllait të tij u ndërthur tek shtylla kurrizore e Lentini-it. Kështu, ai kishte 3 këmbë. 11 vëllezërit dhe motrat ishin normalë dhe prindërit refuzuan ta rrisnin. E dërguan në jetimorë dhe aty hodhi hapat e parë drejt futbollit



dhe performancave në cirk.

**FËMIJA TMERRËSISHT I ZGJUAR, CHRISTIAN HEINRICH HEINEKEN**

Ky djalë, lindi në 1721-in në Gjermani. Babai i tij ishte arkitekt, ndërsa e ëma artiste dhe kimiste shumë e zonja. Kur ishte vetëm 10 muajsh, ai nisi të fliste duke përsëritur emrat e objekteve. Ndonjëherë



formonte edhe fjali. Memoria e tij ishte e pabesueshme dhe kur ishte vetëm 1 vjeç mund të të përmbledhte “New Testament” në latinisht. Kur mbushi 3 vjeç ai jepte leksione rreth historisë daneze. Fatkeqësisht, jeta për të zgjati vetëm 4 vite,

për shkak të intolerancës ndaj glutenit, sëmundje rreth të cilës asokohe s’kishte asnjë informacion.

**NJERIU ME 24 PERSONALITETE**

William Milligan kishte një çrregullim shumë të rrallë psikologjik. Ai zotëronte rreth 24 personalitete, të cilët nuk ishin përgjegjës për njëri tjetrin. Vetë Eilliam



mund të kontrollonte vetëm personalitetin e tij, Billy-in, por jo të tjerët. Në mendjen e tij kishte gra, burra, fëmijë dhe njerëz me nivele të ndryshme inteligjence që kishin karaktere dhe gjuhë të ndryshme.

**BINJAKET E HESHTURA (JUNE DHE JENNIFER)**

Në 1963-in në Barbados lindën 2 bin-



jake, që më pas u quajtën “binjaket e heshtura”. Vajzat nuk flisnin me askënd përveç njëra tjetrës në një gjuhë që e kuptonin vetëm ato. Prindërit u përpoqën t’i ndanin vajzat që të komunikonin edhe me njerëz të tjerë. Kjo e bëri edhe më keq situatën. Kur binjaket u kthyen nga studimet e mbronin edhe më shumë veten dhe njëra tjetrën nga bota. Kalonin shumë kohë në dhomën e tyre. Krijonin poezi dhe historitë (të frikshme) dhe i shkruanin në ditarret e tyre. Kur u lodhën duke shkruar për krimet e të tjerëve, nisën të binin krime vetë. Pasi gjykata mori dënimin për to, i dërguan në një spital psikiatrik. Ndonëse vajzat ishin të ndara, ia dilnin të ishin identike në çdo moment. Edhe kur pozonin merrnin të njëjtin kënd. 11 vite më pas, një gazetare e cila i ndihmoi të trajtoheshin në një tjetër spital tregon se njëra prej binjakeve i tha: “Do të më duhet të vdes.” E pyetur pse, ajo i ishte përgjigjur gazetares: “Sepse kështu e vendosëm ne.” Dhe në fakt, vdiqën.

poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\* poezi \*\*\* poezi



Ndue Mici

**DEPUTETIT KOLË PRELA**

Ti ishe i ri, kishe ideale  
Për At dheun tënd, jetën ti e fale  
Në Altar të Kombit, ti fale rininë  
Gëzimin e jetës edhe lumturinë.

Vuajte si Jezusi në kryq i mbërthyer  
Por mbete në këmbë, e i papërlyer  
Durove tmerre, durove torturë  
Por nuk u dorëzove, mbete deli burrë.

E deshe vatanin, e deshe Shqipninë  
E deshe Shkodrën, e deshe malësinë  
Për këtë dashuni edhe të vërtetën  
Ti sakrifikove rininë edhe jetën.

Ballas me gjoks, i dole mjerimit  
E kurrë nuk tu dridh qerpiku i synit  
Se ti kishe lindur nga fisi i trimit  
Djali petrit i Shoshit, bir i Dukagjinit.

**TË MIRAT E KËSAJ POLITIKE**

Ata shijojnë kënaqësinë e shkëlqimit  
Nuk njohin vuajtjen, e as mjerimin  
Janë të kënaqur, kanë performancë  
Të qetë e të lumtur si në vakancë.

Ne të rrethuar ngado me halle  
Varfëri, mjerim e vuajtje travaje

Pa bukë, pa shkollë, e pa mjekësi  
Mbetur injorantë në terrin e zi.

**PËR ZJARRVËNËSIT**

Vendin më të bukur që ty ta dha Zoti  
Ti po e shkatërron, veç për gjëra koti  
Ate që natyra bujarisht ta fali  
Ti po i vë flakën, po e ban zhari.

Ndale për një çast atë dorë mizore  
Thirri mendjes fort, a po më dëgjon  
Kur ti natyrën e çart këso dore  
Të ardhmen tënde mik, ti e shkatërron.

**THIRRJE PËR DASHURINË**

Kur pranë meje ti kalon  
As me sy nuk më shikon  
Një fjalë të vetme nuk më thue  
Unë zverdhem, bëhem ftue

Kem nevojë për dashurinë  
Aty gjejmë lumturinë  
Jeta bëhet më e bukur  
Ditët shkojnë e vijnë si flutur

Fjalë e ambël dashuri  
Asht më e bukura stoli  
Sjell hare e sjell gëzim  
Lidh dy zemra në betim.

Ndalu pra, e thuaj një fjalë  
Fjalë të ëmbël për një djalë  
Që të ndjek e sheh me mall  
Dhe betohet me të marrë.

**LOZONJARJA**

Gjumi i natës s’ më merr fare  
E jam zhytur në mendime  
Për një vajzë lozonjare  
Që ka mbet’ në mendjen time.

Shtat selvi, belin e hollë  
Kalon rrugës, porsit flutur  
Façekuqë porsit mollë  
Nuk ka tjetër më të bukur

Buzët e njoma, fjalën mjaltë  
Sytë e zezë, e vetull njalë  
Lëshon hire si një hanë  
Merr në qafë ma t’ mirin djalë.



Luigj Temali

**FLAMURI YNË**

Larg në shekuj në histori  
Përmes luftës burrërore  
Yll Polar të patëm ty  
Dhe do t’ kemi n’ çdo fitore.

Ke shqiponjën e Kastriotit  
Kur t’ shpalosi në at’ nëntor  
Pas errësirës qielli ndriti  
Lum drite solle në Vlorë.

Je burim i përparimit  
Të gjithë kombin e bashkon  
Nderi yt besa shqiptarit  
Porsi Dielli kur agon.

O flamur i Shqipërisë  
Zemrat tona gëzon  
Të valvit flad i lirisë  
Drejt progresit na frymëzon.

**LULËKUQES**

Jehona e betejave  
Për ty, Atdhe  
Kur vjen pranvera  
Lajme sjell për ne.

Ngjyra kuq e zi  
Re që gjëmon  
Dëshmorët për liri  
Ti na i kujton.

Lulëkuqe e majit  
Bukuri e rrallë  
Ajo pret djalin  
Me dashuri e mall

Në mes të gjelbërimit  
Të ulur bisedojnë  
Me ndenjat e gëzimit  
Lulëkuqet i rrethojnë.

### NANË TEREZA

Në agim Dielli më shumë ndriti  
Një gonxhe drandafili lule për ne çeli  
Ajo hodhi rrenjë në tokën e Arbërit u rritë  
Nanë Tereza, njerëzimi thirri një ditë.

Prej Atit engjulli si pëllumb i bardhë erdhi  
Dashuri pa kufi në zemrën tënde solli:  
“Dëgjo motër zërin e të mjeruarëve sa gjëmon  
Ata vuajnë kudo, askush s’ i ndihmon!”



E mjera kërkon qumësht për fëmijën nga gjiri i saj  
Ai po i vdes në duar, ajo ka vetëm lotë e vaj.  
U plake e re, shumë halle të ranë mbi kokë  
Por kurrë s’u mposhte gjithëmonë qëndrove e fort.

Në mes skamjes e mjerimit, vuajtjeve pa fund  
Djersa dhe netët pa gjumë sot bëjnë një lum.  
Motrat tuaja shërbejnë në të gjithë Botën  
Misionare të dashurisë, rreze drite e kësaj toke.

Fjalë e mia i thura me lule dhe flori  
Themelët e veprës tënde u hodhen në Indi  
Nga thellësitë e shpirtit u përpoqa sa munda  
Çdo ditë të kujtojnë Shqipëria e Kalkuta.

Zemërmadhe te një trup i vogël  
Për nderin e kombit more çmimin Nobel  
Shpirti yt në Qiell yll që nuk shuhet  
Në shoqërinë e shenjtëve pa pushim lutët.

### HANË E BUKUR

Nga dritarja Hanë e bukur  
Të përshëndes në këtë mbramje  
Sinqerisht më bane të lumtur  
Zemrën time ti m’a kënaqe!

Rrumbullake plot shkelqim  
Glob i artë mbi ne qëndron  
Po ndriçon qytetin tim  
Dhe errësiren e largon.

Prej “Babushit” e mer dritën  
Për ta sjell në shtëpitë tona  
Naltë në Qiell qëndron vetëm  
Shpesh të shohim edhe në andrra.

Të faleminderit Hanë e bukur  
Ti udhëtarin e ndihmon  
Rrezët tuaja si impulse  
Dashuri për ne dergon.

### E DI SHUMË MIRË

E di shumë mirë  
Dhe gëzohem pa masë  
Tek ti prap do vij  
Jam e futur në grackë.

Po hapem sot  
Dhashë shumë premtime  
Kështu e ka kjo botë  
Të mbajnë me therime.  
Por, mos u mërzi  
Kalon shpejt një vit  
Vjen prap behari  
Përsëri rritet bari  
Don ujë i shkreti  
Thahet nga të nxehtit.

Gjithësesi ki besim  
Dielli lind në agim  
E jotja do jem...!  
Shpirti im...!

Lum si ju pula  
“Lum si ju pula  
Jetoni në bashkësi”  
Kështu mendoj Lula  
Kur po kthehej në shtëpi.

Në shulla jeni mbledh  
Së bashku po rrini  
Unë ju kam sjell  
Një pjatë kokra misri.

Të gjitha kakarisni  
Me shpejtësi u shpërnat  
Burrin tuaj e thërrisni  
Kështu veprojnë gratë.”

Asht kaposht me nder  
Edheë trim i radhë  
Gjithëkujt kurdoherë  
I thotë vetëm ndal.

Si sulltan “Pekmezi”  
Ka një harem  
Pulat kush i preku  
Për ato bahet zjerm.

Kush s’don me u tund  
Për herë i ri me mbet  
Të hajë nga një pulë  
Kurrë s’ka me dekë!

Gjeli ki –ki- ki -ki:  
“Filloj zbardhi drita  
Çohuni pleq e të rinj  
Përsëri erdhi dita.”

“Nuk ka pula plaka”  
Tha me vedi Lezja  
“Aty ku del glaca  
Del edhe veza.”

### E SHKRETA TI

Eh...!  
Si je ba...!?  
Më dhemb zemra  
Me të pa!  
Me duhan e fernet  
Hiq dorë nga ky ves  
Moj e shkretë!

Kam dhimbje  
Shoqja ime!  
Mos u dorëzo  
Qëndro trime

Lere duhanin  
Rakinë  
Fernetin  
Ata janë helme...!  
Të shkatrojnë  
Shëndetin...!  
Edhe xhepin...!

### MBAS KALIT

Fatzi, mbas kalit me karrocë të kanë lidhë  
Në Pazar te kasapi me të dorëzu  
Ti kundërshton, kokën me dy brirë e lëvizë  
Për kurban pronari të ka caktu.

Edhe për ty kal shpesh herë më zen mërzia  
Bretku të ra në punë, të zitë e ullirit heq  
Të kanë lanë pa ngranë, të shkatrojo uria  
Nga koka deri në kambë dridhesh si portekë.

Boll ma, mos rri urtë, kështu s’ka kuptim jeta  
Fuqia e jote asht e madhe sa dhjetë vetë  
Kush pasunohet zjarr do i bahet djersa  
E papaguar që ti derdhe për shumë vjet.

Për ty caktohen vetëm disa qindarka  
Padronëve u bie sëpata në mjalt!  
Me zotëri e shërbëtor asht mbush bota  
Disa në pesë yje, të tjerët në barakë!

Kur të moren i mjerë nana lopë u mërzi  
Ajo të rriti me mundime pa fund  
Zemrën e saj e goditi një pikë  
Ra për tokë, iku e shkoj... e gjetën në lum!

Ti linde naltë në bjeshkë nën një lis  
Atëherë ishte verë dhe bante vapë  
Ulun në dy gjunj çdo ditë pije sisë  
Dhe në oborr kërcëje me vrap.

### DO LUFTOJ KORUPSIONIN

Do luftoj korupsionin  
Mos të mbes hajdut në kambë  
Du fitimin, kush e mori?  
Shko, pyet tek jot amë!?

Jam “vezir” nën “Sulltanin”  
Mbi mu është vetëm ai  
Vëlla të madh kam “shejtanin”  
Burr flori njëqind e njëmijë.

Kam para sa të doni  
Emri im s’figuron askund  
Për ato interesohet Loni  
S’ka termet që e tund!

Përrjasht do i shporim  
Jemi të gjithë parimor  
Pa benzinë s’punon motori  
Pa para s’ka dasmorë.

Korupsioni është si horri  
I pa fytyrë mbetet për jetë  
Ai të ngjitet pors morri  
Në çdo lesh keni me e gjetë!

Bën i pari, paguen katundi  
Dëgjoni, keni kujdes!  
Nuk lëvizi kurrë nga vendi  
Ky që jam përherë do mbes!

### Lazer Preka

### KËSHTU E NIS KËNGËN BILBILI

O bilbil,  
Mblidhe veten, del në derë,  
Të qofsha falë,  
Se këtu dimri s’bëhet verë...

Tërë mali mbi mëhallë,  
Bjeshkës i vinë vërdallë...  
Të shtatë liqenjtë zemërbardhë.

Ah si ofshajnë  
Kështu e nis këngën bilbili.  
Si NAIMI.  
Shqipëri të qofsha falë!

Pyesin lissat:  
Vendin e kemi në BIBËL!

### BALADA E PAMBARUAR

Nga qafat e malit zbritën në log  
Togje, togje turmat . . .  
Të përzhitura nga dielli,  
E ngrica e borës.

Nëpër plasat e shkëmbenjëve  
Shtërzen bari.  
E në gishtat e dorës . . .  
Ca klithma përcjellin ushtimën e baladave.

### O DEDË GJON LULI!

Xhamadanat e kuq  
Shpalosin currat e djegur  
Nga duhma e flakëve...

Njëri pas tjetrit,  
Erdhën burrat...  
(Dashkan veten me sundua)

### A E DINI SE...

...dhe hapi drita  
Kraholin e saj.  
Q e dini se!

Bilbili këngët,  
Hë për hë,  
i ka për zemër.  
Ndaj thëllënza del kaq herët . . .

Në vetull të prozimit,  
Bilbilin e kapi për mënge.

### NË TAKIM

Në një takim.  
Nuk dinim gjë  
As unë, e as ti...

Buzëqeshim të dy  
Pa ditur se,  
U bëmë një...

Tok me natyrën,  
Gazmohen yjet.  
Më shumë se NE.

# KULLA E ISA BOLETINIT U MBUSH PËRLOT ME PLIS BARDHË

NË KULLËN MUZE TË ISA BOLETINIT U MBAJT PJESA E TRETË E EDICIONIT TË PESTË TË MANIFESTIMIT "DITA E PLISIT"

Pjesa e tretë e Veprimtarisë së pestë me radhë të manifestimit tashmë tradicional mbarëkombëtar "Dita e Plisit" që është manifestim i ideuar nga Ismet Krasniqi – Lala e në përkrahje të Këshillit të përgjithshëm të njerëzve të kulturës e artit nga Klina (Prend Buzhala, Idriz Berisha, Gjon Gjergjaj e Alban Gashi), kësaj radhe u mbajt në Kullën Muze të Isa Boletinit në Boletin të Shalës së Bajgorës. Organizimin kësaj radhe e mori përsipër Teatri i Qytetit "Sandër Prosi" në krye me Halit Baranin dhe institucionet kulturo-trashëgimore të Mitrovicës.

Manifestimi nisi me homazhet dhe vendosjen e kurorave pranë shtatorës së Isa Boletinit në Mitrovicë dhe marshimin e pjesëmarrësve nëpër rrugët e Mitrovicës për të vazhduar më pas rrugën për në Boletin. Edhe në Boletin u bënë nderime pranë varrit të heroit Isa Boletini dhe u vizituan ambientet muzeore të Kullës së Isa Boletinit.

Në hyrje të kompleksit të Kullës së Isa Boletinit mysafirët nga trojet e ndryshme shqiptare u pritën ngrohtësisht nga burrat shaljanë të cilët u dëshiruan mirëseardhje në Shalën e Bajgorës, në Shalën e Isa Boletinit.

Që në fillim të programit Ismet Krasniqi-Lala, tha se kësaj radhe moderimin e manifestimit do ta bënte njëri nga organizatorët lokal dhe ia kaloi fjalën Hysni Sylës, i cili fillimisht në emër të qytetarëve të Mitrovicës i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi organizatorët që e kanë zgjedh këtë mes për të mbajtur pjesën përmbyllëse të edicionit të pestë të manifestimit "Dita e plisit". Ndër tjera ai tha : " Është një nderë i veçantë për ne shaljanët, sepse bartja e plisit ishte traditë e kamotshme shqiptare në rajonin e Shalës së Bajgorës dhe të Mitrovicës. Në fotografi të moçme që po dalin nga arkivat gjithandej, banorët e kësaj ane nuk ishin ndryshe, pos me plis."

Më pas të pranishmit i përshëndeti dhe ju dëshiroj mirëseardhjeje edhe kryetari i Mitrovicës Agim Bahtiri, i cili edhe një herë tha se kjo tokë është

e jona dhe e jona do të mbetet, nuk do të ketë ndarje të tokave shqiptare dhe as të kësaj ane. Pra Mitrovica do të jetë e pa ndarë tha Bahtiri.

Më pas me një fjalë para të pranishmëve u paraqit Rrezarta Loxha ,drejtoresh e Qendrës Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Mitrovicë, që e kishte mbështetur materialisht manifestimin e Ditës së plisit në Kullën e Isa Boletinit.

Gazmend Boletini, stërnip i Isa Boletinit para të pranishmëve foli me shumë emocione ngase ndjehej shumë i lumtur që ky manifestim mbahej në



kullën muze të stërgjyshit të tij, për çka edhe falënderoi organizatorët dhe të gjithë pjesëmarrësit.

Monologu kushtuar plisit u pritë mjaft ngrohtë nga të pranishmit e të cilin e deklamoi Venera Bojaj.

Shkrimtari, publicisti dhe njëri nga organizatorët e përherëshëm të manifestimit Prend Buzhala, para të pranishmëve u paraqit me kumtesën e tij mjaftë përmbajtjesore të titulluar "Kulla dhe plisi".

Manifestimi si gjithëherë u freskua

me një këngë rapsodike nga Nazmi Hajdari.

Ndonëse ishte paraparë që në këtë manifestim të paraqitet me një kumtesë edhe Dr. Jahja Dtançolli, por siç u tha nga moderatori ai nuk ishte prezent ngase ndodhej në një aktivitet të rëndësishëm në Dubrovnik të Kroacisë, ku mban një ligjëratë për Gjin Gazullin.

Profesori dhe shkrimtari i njohur i Shalës së Bajgorës Fazli Hajrizi, para të pranishmëve u paraqit me kumtesën e tij të titulluar "Plisi i bardhë-pjesë e kostumit popullor dhe simbol mijëra

respekt e pranoi Gazmend Boletini.

Pastaj përshëndeti Agron Isa Gjedia, kryetar i shoqatës "Bytyqi" Tiranë-Prizren, i cili ideatorit të këtij manifestimi i dhuroi dy botimet e kësaj shoqate që janë botime kushtuar plisit, aktivitet të cilin Gjedia më shoqatën e tij e realizon tash e disa vite në Tiranë. Po ashtu ai shpërndau edhe gazetën "Bytyqi" që e boton kjo shoqatë. Me fjalë përshëndetëse u paraqitën edhe Rrahman Lajçi, Avdyll Hoxha nga Oda e Junikut, Ramë Mrija nga Tropoja, Vlora nga Amerika, prof. dr. Mehmet Rukiqi etj.

Edhe rapsodët nga Shkodra ia thanë këngës në Kullën e Isa Boletinit, më pas u ndan disa mirënjohje nga Teatri i qytetit "Sandër Prosi" për ata që dhënë kontributin më të madh në organizimin e këtij manifestimi.

Në fund duke e shpallur të mbyllur aktivitetin e kësaj dite, ideatori i manifestimit Ismet Krasniqi-Lala pasi ka falënderuar pjesëmarrësit tha se në të ardhmen nuk do të quhet më Manifestimi "Dita e plisit", e që paralajmëroi se në vitin e ardhshëm aktivitetet "Ditët e plisit" do të mbahen në Jezerc të Ferizajt, në kullën e Ahmet Delisë në Drenicë, në Zym të Hasit.

Si zakonisht për të pranishmit vendasit kishin shtruar ushqime tradicionale. Edhe në hapësirat jashtë kullës muze nuk mungoi kënga dhe zëri i ëmbël i çiftelisë, sharkisë e lahutës që tingëllojnë aq bukur në këto male të larta të Shalës së Bajgorës nga Rapsodi Nazmi Hajdari me grup, dhe grupet rapsodike nga nga Shkodra e Mitrovica.

Ashtu si erdhën pjesëmarrësit edhe u larguan nga kompleksi i kullës muze të "Isa Boletinit" të përcjell nga burrat e kësaj ane.

Pjesëmarrësit aty ku u takuan pranë shtatorës së Isa Boletinit në Mitrovicë aty edhe u ndalën sërish për të marr edhe ndonjë foto dhe për tu përshëndetur me dëshirën që të takohen edhe në manifestimet tjera të radhës.

Milazim F. KADRIU

## REDAKSIA

Kryeredaktore: Suela Ndoja

Redaktorë: Kole Çardaku, Prele Shytani, Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj, Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e Ndue Ziçi.

Mundësoi Botimin:

**AV. ANTON KOSTERI**

Anëtar i Shoqatës Atdhetare Dukagjini, Shkodër

